




# RAPORTI I VLERËSIMIT TË KORRUPSIONIT SHQIPËRI



Copyright © 2014, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Lidhshipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)

### **Falënderime**

Ky raport është përgatitur nga ACER nën drejtimin e Qendrës për Studimin e Demokracisë (CSD, Sofje - Bullgari) në kuadër të rrjetit të SELDI-t.

### **Koordinimi i kërkimit dhe përgatitja e raportit:**

Zef Preci (ACER)  
Jonida Narazani (ACER)  
Ami Narazani (ACER)  
Brunilda Kosta (ACER)  
Alba Cela (House of Europe)

### **Sondazhi:**

Fatmir Memaj (Albanian Socio-Economic Think Tank, ASET)  
Albana Idershaj (Albanian Socio-Economic Think Tank, ASET)

Falenderime të singërta shkojnë për studentët e Masterit Shkencor, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, për angazhimin e tyre në plotësimin e pyetësorëve në terren.

### **Partnere e Projektit:**

House of Europe, Tirana (Albania)

### **Dizenjimi:**

MetalArt shpk.

Falënderojmë Z. Ruslan Stefanov (CSD), Zj. Daniela Mineva (SCD), Z. Stefan Karaboev (CSD) dhe Z. Boyko Todorov, për kontributin e tyre gjatë realizimit të këtij raporti. Sondazhi, mbi të cilin është bazuar ky raport, ka ndjekur metodologjinë e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit.

Dr. Alexander Stoyanov dhe Z. Alexander Gerganov (Vitosha Research) kanë dhënë udhëzimet metodologjike për kryerjen e sondazhit dhe për dhënien e rezultateve



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Evropian.

SELDI është një nismë e hapur, duke synuar vazhdimisht të zgjerohet dhe të tërheqë organizatat e shoqërisë civile (OJF-të), politikëbërësit dhe palë të tjera, të cilët mund të kontribuojnë në qëllimet e tij, të ndajnë përvojën dhe të mbështesin mirëqeverisjen dhe masat anti-korrupsion në vendet e Europës Jug-Lindore.

Janë konsultuar 140 palë të interesuara anti-korrupsion (OJF, politikë-bërës, organizata ndërkombëtare, studiues dhe gazetarë nga 9 vende), të cilët ofruan komente/informacione të vlefshme për përmirësimin e Strategjisë dhe Axhendës së Veprimi të SELDI-it.

Anëtarët themelues të koalicionit SELDI:

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqipëri

Qendra për Tranzicion Demokratik, Mali i Zi

Qendra për Raportim Investigativ (CIN), Bosnje Hercegovinë

Qendra për Studime Liberal-Demokratike (CLDS), Serbi

Qendra për Studimin e Demokracisë (CSD), Bullgari

Forumi për Veprim Qytetar FORCA Pozega, Serbi

Shtëpia e Europës (HoE), Shqipëri

Instituti Alternativ (IA), Mali i Zi

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS), Republika e Maqedonisë

INSTITUTI RIINVEST, Kosovë

Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI), Kosovë

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Republika e Maqedonisë

Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Çështje Ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë

Partneriteti për Zhvillimin Social (PSD), Kroaci

Sekretariati Rajonal i Iniciativës Anti-korrupsion (RAI), Bosnje Hercegovinë  
"Syri i Vizionit", Kosovë

Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Sociale (TESEV), Turqi

ISBN: 978-954-477-201-7

2013, Udhëheqja e Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)

 Creative Commons License

Attribution-NonCommercial-NoDerivs 3.0 Unported

Qendër për Studimin e Demokracisë

5 Alexander Zhendov Str.

1113 Sofia

tel.: (+359 2) 971 3000

fax: (+359 2) 971 2233

csd@online.bg

www.csd.bg



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyre nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Evropian.

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PIKAT KRYESORE</b>	<b>8</b>
<b>HYRJE</b>	<b>9</b>
<b>I. NIVELET E KORRUPSIONIT</b>	<b>10</b>
1.1 Indekset e korrupsionit	
1.2 Përhapja dhe dinamikat e korrupsionit	
1.3 Qëndrimi ndaj korrupsionit	
1.4 Perceptime mbi korrupsionin	
1.5 Perceptimet mbi realizueshmërinë e të politikave të korrupsionit	
<b>II. POLITIKAT ANTIKORRUPSION DHE KUADRI RREGULLATOR</b>	<b>23</b>
2.1 Strategjitë, planet e veprimit dhe programet aktuale të zbatueshme	
2.2 Zhvillimet në kuadrin rregullator	
2.3 Ndryshimet në politikat kombëtare antikorrupsion gjatë tre viteve të fundit	
2.4 Vlerësimi i kuadrit rregullator për antikorrupsionin	
2.5 Ligji dhe procedura penale	
2.6 Ligji civil dhe procedurat	
2.7 Legjislacione të tjera që luftojnë korrupsionin	
Rekomandime	
<b>III. PRAKTIKAT INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI I LIGJIT</b>	<b>27</b>
3.1 Mekanizmat antikorrupsion në legjislacion	
3.2 Roli i organeve kombëtare në luftën kundër korrupsionit	
3.3 Administrata e përgjithshme publike	
3.4 Zbatimi i ligjit	
3.5 Q Indikatorët sasiorë për zbatimin e dispozitave të ligjit antikorrupsion	
Rekomandime	
<b>IV. ROLI I GJYQËSORIT NË ANTIKORRUPSION</b>	<b>31</b>
4.1 Statuti i gjyqtarëve	
4.2 Dispozitat ligjore dhe strukturat që merren me korrupsionin midis magjistratëve	
4.3 Dispozitat ligjore për imunitetin dhe mbrojtja kundër largimit nga puna	
4.4 Statistikat mbi procedurat disiplinore kundër korrupsionit	
4.5 Kodi i etikës/sjelljes	
Rekomandime:	

<b>V.</b>	<b>KORRUPSIONI DHE EKONOMIA</b>	<b>37</b>
5.1	Korrupsioni politik	
5.2	Korrupsioni dhe mjedisi i biznesit	
5.3	Ekonomia informale dhe korrupsioni	
5.4	Shpenzimet e buxhetit qeveritar dhe ri-shpërndarja e tij	
5.5	Prokurimi publik dhe korrupsioni	
	Rekomandime	
<b>VI.</b>	<b>SHOQËRIA CIVILE NË ANTIKORRUPSION</b>	<b>43</b>
6.1	Shoqëria civile dhe anti-korrupsioni në Shqipëri: një paraqitje e përgjithshme	
6.2	Fushat e përfshirjes dhe projektet e shoqërisë civile	
6.3	Praktikat më të mira mbi antikorrupsionin	
6.4	Partneriteti publik-privat kundër korrupsionit	
6.5	Korrupsioni brenda shoqërisë civile	
	Rekomandimet	
<b>VII.</b>	<b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR</b>	<b>48</b>
7.1	Progres Raporti për Shqipërinë	
7.2	Asistenca e huaj në fushën e kundër-korrupsionit	
7.3	Renditjet sipas Transparency International	
	Rekomandime	

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Indikatorët e vlerësimit të korrupsionit nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit	10
Grafiku 2: Bashkëveprimi midis indikatorëve të korrupsionit	11
Grafiku 3: Sipas mendimit tuaj, cilat janë tre problemet madhore aktualisht në Shqipëri?	11
Grafiku 4: Identifikimi i praktikave të ngjashme të korrupsionit (2014)	12
Grafiku 5: Vlerësimi juaj mbi përhapjen e korrupsionit në Shqipëri, bazohet kryesisht në:	13
Grafiku 6: Dinamikat e indeksit të presionit të korrupsionit dhe të përfshirjes në praktikat korruptive	14
Grafiku 7: Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion	15
Grafiku 8: Përfshirja në korrupsion me ose pa presionin e korrupsionit	15
Grafiku 9: Pjesa e popullsisë që kanë patur kontakt me zyrtarët publikë dhe kanë patur eksperiencë korrupsioni	16
Grafiku 10: Pjesa e popullsisë që kanë patur kontakt me zyrtarët publikë dhe janë përfshirë në praktikat korruptive	16
Grafiku 11: Përhapja e korrupsionit	17
Grafiku 12: Pranimi i korrupsionit	18
Grafiku 13: Ndjeshmëria ndaj korrupsionit	18
Grafiku 14: Perceptions of the likelihood of corruption pressure (%)	19
Grafiku 15: Perceptimet mbi zyrtarët e korruptuar –më të korruptuarit	20
Grafiku 16: Perceptimet mbi zyrtarët e korruptuar- më pak të korruptuarit	20
Grafiku 17: Perceptimet mbi zyrtarët publik të korruptuar- ndryshimi i perceptimit midis 2002 dhe 2014	21
Grafiku 18: Pritshmëria për korrupsionin	22
Grafiku 19: Perceptimet e vizibilitetit të politikave të korrupsionit (%)	22
Grafiku 20: Numri i të dënuarve për shpërdorimin e detyrës (2004-2011)	35
Grafiku 21: Dëmi ekonomik në fushën e prokurorimeve për vitin 2012 (në lek 000)	41

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë	30
Tabela 2: Numri i të dënuarve për krime kundër Drejtësisë, Republika e Shqipërisë 2004-2012	33
Tabela 3: Numri i litë akuzuarve dhe të dënuarve për krimet e korrupsionit, 2010-2011	34
Tabela 4: Liria nga korrupsioni	37
Tabela 5: Kontrolli i Korrupsionit, Shqipëri	38
Tabela 6: Vlerësimet sipas Transparency International Ranking	51

## PIKAT KRYESORE

Gjatë tre viteve të fundit, në Shqipëri ka patur disa zhvillime të rëndësishme, të lidhura me korrupsionin, të listuara si më poshtë:

Në vitin 2012, u bë miratimi i disa ndryshimeve që kufizonin imunitetin e gjyqtarëve;

Në Mars, 2014 u bë miratimi i disa ndryshimeve në Procedurën e Kodit Penal për zbatimin e ndryshimeve kushtetuese mbi kufizimin e imunitetit të gëzuar nga gjykatësit, anëtarët e parlamentit si dhe zyrtarë të tjerë të lartë;

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve zbatoi një vendim në Janar 2012, me qëllim rritjen e transparencës;

Në Nëntor 2013, u emërua Koordinatori Kombëtar për Anti-korrupsion (KKAK), për të koordinuar aktivitetet e organeve shtetërore dhe institucioneve të pavarura, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal;

Në mars të vitit 2014 u miratua projektligji me ndryshimet në ligjin "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar", ose i njohur ndryshe si ligji "Anti-Mafia", ku ndryshimi kryesor është përfshirja e "korrupsionit" në fushëveprimin e këtij ligji;

"Ligji i ri mbi Nënpunësin Civil" u bë efektiv në Shkurt 2014 dhe legjislacioni dytësor u miratua në kohë për hyrjen e tij në fuqi në 1 Prill, 2014;

Në Shtator 2014, u krijua Njësia për hetimin e korrupsionit dhe pasurive, pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda, i cili do të hetojë rastet e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe zyrtarëve të lartë publik;

Ligji i ri "E drejta e informimit për dokumentet zyrtare", u aprovua në Shtator, 2014.

## HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit 2014, vlerëson progresin e anti-korrupsionit në Shqipëri, duke eksploruar lidhjen midis politikave qeveritare anti-korrupsion, strukturave institucionale të qeverisë dhe nivelin e shfrytëzimit të korrupsionit.

Motivimi mbas kësaj qasjeje të tillë është se ndërtimi institucional i qeverisjes përcakton rregullat legjitime për të gjithë sektorët e shoqërisë. Korrupsioni është një shkelje e këtyre rregullave i cili ka si qëllim interesat private. Kjo ndodh kur rregullat e vendosura janë jofunksionale ose kur zyrtarët publikë me qëllim shkelin normat institucionale, ligje, etj në mënyrë që të përfitojnë dhe / ose sigurojnë privilegje për të tjerët.

### **Metodologjia e Vlerësimit të Korrupsionit**

Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit është i fokusuar në tre fusha kryesore:

Rezultatet dhe gjetjet e sodazhit kombëtar. Kjo metodë mat dinamikën e përhapjes së korrupsionit administrative midis populli (+18 vjeç);

Politikat specifike të qeverisë kundër korrupsionit. Këto politika adresojnë shkeljet korruptive nga strukturat qeveritare dhe kanë si qëllim ruajtjen dhe zbatimin e pajtueshmërisë me mekanizmat e vendosura të qeverisjes.

Struktura ligjore dhe institucionale të regjimit të qeverisjes nga pikëpamja e potencialit të saj për të luftuar korrupsionin dhe / ose për të gjeneruar korrupsionin.



## I. NIVELET E KORRUPSIONIT

Anketat e opinionit publik për fenomenin e korrupsionit, nxjerrin në pah informacione të nevojshme mbi nivelet e korrupsionit, qëndrimet, mentalitetin dhe pritshmëritë e njerëzve në lidhje me korrupsionin.

Të vlerësuarit e korrupsionit duke marrë në konsideratë këndvështrime dhe aspekte të ndryshme mbi të, ofron një pamje më gjithëpërfshirëse të kësaj dukurie si dhe nivelin e përhapjes së tij në institucionet shtetërore, qeverisjen publike si dhe në shoqëri në tërësi.


Një pjesë e rëndësishme e këtij raporti vlerësues të korrupsionit janë rezultatet dhe gjetjet e vërtetimit kombëtar të realizuar në periudhën Shkurt-Mars 2014.

Vërtetimi i realizuar u bazua në metodologjinë e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit (Grafiku 1: Treguesit e vlerësimit të korrupsionit nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit), i cili është zbatuar për dy vërtetime të tjera kombëtare të ngjashme në 8 shtete të Evropës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, në kuadër të SELDI 2001 dhe 2002.


Pavarësisht diferencave të mëdha kohore midis viteve, rezultatet japin mundësinë e një vlerësimi mbi dinamikën dhe tendencat e treguesve kryesorë të korrupsionit. Vërtetimi është kryer më një shembull prej 1000 të intervistuarish, nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë.

Treguesit kryesorë të këtij vërtetimi vijnë në formën e indekseve të cilat përmbajnë një ose më shumë pyetje kërkimore dhe marrin vlera nga 0 deri në 10. Sa më pranë vlerës 10 të jetë indeksi, aq më negativ është vlerësimi mbi korrupsionin, ndërsa sa më afër vlerës 0, aq më pozitiv është vlerësimi për korrupsionin.

Grafiku 1: Indikatorët e vlerësimit të korrupsionit nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit



Grafiku 2: Bashkëveprimi midis indikatorëve të korrupsionit




## 1.1 Indekset e korrupsionit

Gjatë vlerësimit të korrupsionit në një vend të caktuar, duhet të merren në konsideratë disa kushte të tilla si: situata e përgjithshme social-ekonomike apo probleme të tjera të rëndësishme me të cilat përballet vendi, të cilat mund të lidhen me nivelin e korrupsionit në vend.

Të pyetur për tre problemet më të mëdha në Shqipëri në ditët e sotme, 66% e të intervistuarve, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe, kanë përcaktuar korrupsionin, 56% e tyre kanë përcaktuar papunësinë, ndërsa 40% dhe 38% kanë përcaktuar krimin dhe të ardhurat e ulëta (Grafiku 3). Shumica e të anketuarve raportojnë se korrupsioni është problemi më madhor në Shqipëri, duke tejkaluar kështu probleme të tjera më të zakonshme si për shembull papunësinë apo të ardhurat e ulëta, të cilat kanë një ndikim më të drejtpërdrejtë në jetën e të anketuarit dhe për pasojë janë më të matshme dhe më intuitive për të të shkuar mendja.


Grafiku 3: Sipas mendimit tuaj, cilat janë tre problemet më madhore aktualisht në Shqipëri?



Siç mund të vërehet në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 4), 64 % e të anketuarve janë shumë të informuar në lidhje me çështjen e korrupsionit në Shqipëri. Nga ana tjetër, ky rezultat shkon në të njëjtën linjë me rezultatin në lidhje me problemet madhore në Shqipëri, ku 66 % e të anketuarve kanë përcaktuar korrupsionin.

Grafiku 4: Ndërgjegjësimi (identifikimi) i praktikave korruptive më të zakonshme

(% e popullsisë 18+ te informuar mbi praktika korruptive- të gjithë (e lartë), shumë (moderuar) dhe pak (ulët))




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Perceptimi i përgjithshëm mbi korrupsionin mund të ketë qenë gjithashtu i formuar në bazë të mbulimit pompoz mediatic të skandaleve të korrupsionit politik në vend të përvojave të qytetarëve apo dijenive mbi rastet e ryshfeteve. Të anketuarit janë pyetur në lidhje me bazat mbi të cilat është formuar vlerësimi i tyre mbi nivelin e përhapjes së korrupsionit. 29 % e të anketuarve kanë përcaktuar përvojat e tyre personale, ndërsa 35 % e tyre kanë përcaktuar informacionin e marrë nga media (Grafiku 5).

Pjesa e të anketuarve që e bazojnë vlerësimin e tyre mbi korrupsionin, bazuar në përvojën e tyre apo të të tjerëve, përbëjnë rreth gjysmën e të anketuarve, duke treguar në këtë mënyrë nivele të larta të përvojave mbi rastet korruptive. Personat që bazojnë vlerësimin e tyre në përvojën personale të tyre apo të njohurve të tyre, përbën gjysmën e të anketuarve, gjë që tregon se në fakt ka patur raste të shumta përvojash korruptive midis të anketuarve.

Grafiku 5: Vlerësimi juaj mbi përhapjen e korrupsionit në Shqipëri, bazohet kryesisht



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

## 1.2 Përhapja dhe dinamikat e korrupsionit

### 1.2.1 Presioni ndaj korrupsionit dhe përfshirja në praktikat korruptive

Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit (CMS), përdor indekset e përbërë, për të vlerësuar qëndrimet, nivelin e përhapjes, dinamikat dhe karakteristika të tjera të korrupsionit në një shtet të caktuar. Për vlerësimin e nivelit të përhapjes së korrupsionit duhet të mbahen në konsideratë dy tregues të dallueshëm: korrupsioni potencial dhe korrupsioni faktik dhe këto janë të ndërlidhur se bashku pasi janë pjesë e një procesi më të gjatë dhe të gjerë të quajtur transaksioni i korrupsionit. Korrupsioni potencial ndodh në fazën e parë të transaksionit të korrupsionit, kur qytetari bie në kontakt me një zyrtar publik, i cili ushtron presionin e korrupsionit duke kërkuar të holla, dhurata apo favore ose tregon shenja se pret gjëra të tilla.


Korrupsioni potencial në këtë raport është i matur nga indeksi i presionit të korrupsionit, i cili raporton frekuencën e rasteve kur të anketuarve u janë kërkuar të holla, një dhuratë, ose një favor ose iu është nënkuptuar që ata prisnin të holla, dhurata ose favore, në mënyrë që të zgjidhnin problemin e tyre. Pra, ky indeks mat rastet e përpjekjeve të zyrtarëve publik për të ushtruar presion direkt apo indirekt tek qytetarët në mënyrë që të sigurojnë para, dhurata apo favore.

Korrupsioni potencial është i ndryshëm nga korrupsioni faktik, i cili mat rastet në të cilat ka ndodhur transaksioni i korrupsionit dhe është paguar edhe ryshfeti. Këto dy faza të transaksionit të korrupsionit mund të lidhen me njëra-tjetrën në pikën ku për nivele të larta të korrupsionit potencial, presioni i korrupsionit, mund të çojë në më shumë raste të korrupsionit faktik, ose e thënë ndryshe, përfshirja në praktikat korruptive.

Në këtë raport korrupsioni faktik është matur nëpërmjet indeksit të përfshirjes në korrupsion, që regjistron frekuencën e rasteve në të cilat qytetarët japin të holla, dhurata apo favore të tjera një zyrtari publik, gjatë vitit të fundit. Indeksi reflekton në këtë mënyrë përfshirjen e të anketuarve në forma të shumta të sjelljes korruptive.

Ndërkohë që indeksi i dinamikës së presionit për korrupsion dhe përfshirja në korrupsion nuk shfaqin ndonjë prirje të veçantë, me përjashtim të një rënie të lehtë nga viti 2001 në indeksin e përfshirjes në praktikat korruptive që qëndron në 2.1, është më me vlerë të shqyrtohet pjesa e popullsisë që raporton se ka përjetuar presion për korrupsion apo që kanë qenë të përfshirë në praktika korruptive gjatë vitit të kaluar.

Grafiku 6: Dinamikat e indeksit të presionit për korrupsion dhe të përfshirjes në praktikat korruptive




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Në lidhje me përvojën e të anketuarve mbi presionin e korrupsionit, pjesa e popullsisë që raporton se ka hasur presion për korrupsion ka pësuar një rënie nga 72.8% në vitin 2001, në 61.9% në vitin 2002 dhe në 45.3 % në vitin 2014 (Grafiku 7). I njëjti trend qëndron edhe për përfshirjen në praktikat korruptive, por me një pjesë më të vogël të popullsisë që raportojnë se kanë qenë të përfshirë në raste korruptive.

Megjithatë, këto rezultate mund të çojnë në përfundime të gabuara nëse nuk marrim parasysh se në vitin 2014, një pjesë shumë e madhe e qytetarëve krahasuar me vrotimet e mëparshme, nuk kanë patur fare kontakt me një zyrtar publik. Reduktimi i kontaktit me zyrtarë publik mund të ketë ardhur si rezultat i avancimit dhe përmirësimeve teknologjike gjatë viteve të fundit. Kjo mund të jetë arsyeja pse në përgjithësi pjesa e popullsisë që raporton presion ose është që është përfshirë, është më e ulët.

Grafiku 7: Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion

(% e popullsisë 18+ të cilëve ju është kërkuar dhe kanë dhënë rryshfet (para, favore, dhurata) gjatë vitit të fundit)




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Grafiku 8 paraqet pjesën e popullsisë që ka dhënë rryshfet nën apo pa presion për korrupsion. Pjesa e popullsisë që ka dhënë rryshfet nën presionin e korrupsionit ka rënë, krahasuar me vitin 2001. E njëjta prire vihet re me pjesën e popullsisë, e cila ka dhënë rryshfet pa qenë nën presionin e korrupsionit. Në përgjithësi, pjesa e popullsisë e cila ka dhënë rryshfet ka rënë që nga viti 2001.

Grafiku 8: Përfshirja në korrupsion me ose pa presionin e korrupsionit

(% e popullsisë 18+, që kanë dhënë rryshfet me apo pa presion)




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Në qoftë se marrim në konsideratë vetëm pjesën e popullsisë që kanë patur kontakt vitin e fundit me një zyrtar publik, pjesa e cila raporton se ka hasur presion të korrupsionit paraqitet më e lartë në 2014.

Kështu, pjesa e njerëzve që kanë patur kontakt me administratën, paraqitet më e madhe në vitin 2014, në krahasim me vitet e mëparshme. E njëjta gjë vlen për përfshirjen në praktika korruptive, ku nga të gjithë njerëzit të cilët kanë patur kontakt me zyrtarët publik, 74% kanë pranuar se kanë dhënë rryshfet në krahasim me 58% në 2002 dhe 68% në vitin 2001.


Kjo tregon se, ndërsa reduktimi i kontaktit me zyrtarët publik mund të ketë kontribuar në uljen e numrit të njerëzve që kanë përjetuar presionin e korrupsionit apo që janë përfshirë në rastet korruptive, shanset që një person të hasë presion për korrupsion apo të përfshihet në raste korruptive kur vihet në kontakt me zyrtarë publik janë më të mëdha në 2014 (Grafiku 9).

Grafiku 9: Pjesa e popullsisë që kanë patur kontakt me zyrtarët publik dhe kanë hasur presion për korrupsion



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Grafiku 10: Pjesa e popullsisë që kanë patur kontakt me zyrtarët publikë dhe janë përfshirë në praktikat korruptive



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014


## 1.2.2 Vlerësimi në lidhje me përhapjen e korrupsionit

Perceptimet mbi përhapjen e korrupsionit sigurojnë informacion në lidhje me vlerësimet e qytetarëve mbi nivelin e përhapjes së praktikave korruptive tek punonjësit e sektorit publik. Ndërkohë që presioni i korrupsionit (korrupsioni potencial) dhe përfshirja në korrupsion (korrupsioni faktik) raportojnë rastet aktuale, indeksi i përhapjes së korrupsionit reflekton vlerësimet, perceptimet, opinionet e qytetarëve, të cilat janë të bazuar në vlerësimet e tyre subjektive dhe njohuritë e tyre mbi raste të tilla.

Indeksi merr vlera nga 0 (askush nga administrata publike nuk është i përfshirë në korrupsion), deri në 10 (pothuajse të gjithë nga administrata publike janë të përfshirë në korrupsion). Ky indeks ka pësuar një rritje dhe në vitin 2014 ai është raportuar në vlerën 7.4, e cila është shumë më e lartë se sa rezultati 2.1 i treguesit të korrupsionit aktual.

Siç ndodh zakonisht, perceptimet mbi përhapjen e korrupsionit janë më të larta se transaksionet aktuale të korrupsionit, gjë e cila mund të tregojë se qytetarët mund të kenë perceptime të fryra në lidhje me pranueshmërinë (dhe ushtrimin) e korrupsionit në përgjithësi, gjë që mund të bëjë që ata ta shohin korrupsionin si më të pranueshëm dhe për pasojë të jenë më të predispozuar për t'u angazhuar në praktika korruptive (Grafiku 11).

Grafiku 11: Përhapja e korrupsionit



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014




## 1.3 Qëndrimi ndaj korrupsionit

### 1.3.1 Pranueshmëria dhe ndjeshmëria ndaj korrupsionit

Qëndrimet ndaj korrupsionit janë një tregues i rëndësishëm i mentalitetit të njerëzve në një vend, në lidhje me dukurinë e korrupsionit. Prandaj, sa më i pranueshëm të jetë korrupsioni, aq më e madhe është mundësia që njerëzit të angazhohen në korrupsione të lehta të tilla si ryshfeti. Është ditur që prej shumë kohësh ideja se ryshfetet mund të shihen si një "bakshish", një shpërblim për një shërbim të caktuar. Ky është ndonjëherë rasti edhe në Shqipëri, ku kufiri midis bakshishit dhe ryshfetit, është shumë i vogël. Në këtë raport qëndrimet ndaj korrupsionit zbulohen nëpërmjet dy indekseve, pranimit dhe ndjeshmërisë ndaj korrupsionit. Përqindja e popullsisë që pranon korrupsionin, ka pësuar një rënie në krahasim me vitin 2001. Në vitin 2014, 51% e të anketuarve e pranojnë korrupsionin, në krahasim me 37% në 2002 dhe 53% në vitin 2001 (Grafiku12).

Grafiku 12: Pranimi i korrupsionit

(% e popullsisë 18+, që pranojnë ose jo forma të ndryshme të sjelljeve të korrupsionit)




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Përqindjet e të anketuarve në lidhje me faktin nëse janë të ndjeshëm apo jo ndaj dukurisë së korrupsionit, apo nëse kanë qëndrim miks ndaj tij, janë të paraqitura në grafikun e mëposhtëm (Grafikun 13). Për sa i përket pjesës së të anketuarve që nuk janë të ndjeshëm ndaj korrupsionit, duket se këtë vit (2014) ka një përmirësim në krahasim me vitin 2002.

Grafiku 13: Ndjeshmëria ndaj korrupsionit

(% e popullsisë 18+ që do të jepte dhe /ose do të pranonte ryshfet në rolin e qytetarit dhe/ose zyrtarit)




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Në lidhje me perceptimet mbi mundësinë e presionit të korrupsionit, ashtu edhe siç shikohet nga grafiku i mëposhtëm, pjesa e popullsisë e cila e konsideron presionin e korrupsionit shumë të mundshëm, është 84 % në 2014 .

Grafiku 14: Perceptimit mbi mundësinë për korrupsion (%)

(% e popullsisë 18+ që e konsiderojnë presionin e korrupsionit si "shumë të mundshëm", "të mundshëm" dhe " aspak të mundshëm" )



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

### 1.3.2 Eficenca praktike e praktikave korruptive

Indeksi i efikasitetit praktikë të praktikave korruptive, tregon vlerësimin e qytetarëve për masën në të cilën korrupsioni është një mjet efikas për zgjidhjen e problemeve personale. Vlerat e indeksit variojnë nga 0 (aspak e mundur) deri në 10 (shumë e mundshme).

Ky indeks është përmirësuar nga 7.4 në vitin 2001, në 7.0 në vitin 2002 dhe në 6.3 në vitin 2014, gjë që tregon se qytetarët besojnë në një masë më të vogël se korrupsioni mund të paguajë.

## 1.4 Perceptime mbi korrupsionin


### 1.4.1 Korrupsioni i zyrtarëve publik

Me një shkallë nga 1 deri në 4, ku 1 nënkupton "pothuajse askush nuk është i përfshirë" dhe 4 nënkupton "pothuajse të gjithë janë të përfshirë", të anketuarit perceptojnë si zyrtarët më të korruptuar në 2014, gjykatësit dhe oficerët e tatimeve. Me një shkallë të ngjashme (3.3) janë perceptuar prokurorët publik, zyrtarët e administratës në sistemin gjyqësor dhe liderët e partive politike. Sipas të dhënave, duket se perceptimi për oficerët tatimorë është përmirësuar lehtësisht krahasuar me vitin 2001 dhe 2002 (Grafiku 15).

Nga ana tjetër, sipas rezultateve të 2014 të anketuarit perceptojnë si zyrtarët më pak të korruptuar gazetarët dhe mësuesit me një shkallë 2.2 (Grafiku 16).

Grafiku 15: Perceptimet mbi zyrtarët e korruptuar –më të korruptuarit


Zyrtarë që perceptohen si më të korruptuarit me një shkallë nga 1 në 4, ku 1 do të thotë "Pothuajse askush nuk është i përfshirë" dhe 4 "Pothuajse të gjithë janë të përfshirë".



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Grafiku 16: Perceptimet mbi zyrtarët e korruptuar- më pak të korruptuarit

Zyrtarë që perceptohen si më pak të korruptuarit me një shkallë nga 1 në 4, ku 1 do të thotë "Pothuajse askush nuk është i përfshirë" dhe 4 "Pothuajse të gjithë janë të përfshirë".



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Nga grafiku 17, në të cilin është paraqitur krahasimi i perceptimit mbi korruptimin e zyrtarëve publik midis 2002 dhe 2014, duket se pothuajse të gjithë zyrtarët e përfshirë janë më të korruptuar në vitin 2014 në krahasim me vitin 2002, përveç zyrtarëve doganor, zyrtarët e tatimeve dhe ministrive. Duhet theksuar se ky është një krahasim midis 2004 dhe 2014, dhe tregon nivelin e përmirësimit; edhe pse në vitin 2014 zyrtarët doganorë janë midis zyrtarëve më të korruptuar.

Grafiku 17: Perceptimet mbi zyrtarët publik të korruptuar- ndryshimi i perceptimit midis 2002 dhe 2014ptuarit


Ndryshimi I perceptimit midis 2002 dhe 2014 (pozitive do të thotë rritje të korruptionit, negative-ulje)



## 1.4.2 Pritjet për korrupsionin

Indeksi i pritjeve të korrupsionit regjistron vlerësimet e qytetarëve mbi kapacitetin (potencial) e shoqërive të tyre për të përballur me problemin e korrupsionit, dhe vlerat shkojnë nga 0 (korrupsioni mund të çrrënjohet), deri në vlerën më të lartë të mundshme 10 (korrupsioni nuk mund të reduktohet).

Grafiku 18: Pritshmëritë për korrupsionin




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2014

Pritshmëritë për korrupsionin duket se janë përkeqësuar në vitin 2014 duke kapur vlerën 6.3 krahasuar me 5.5 në vitet e mëparshme. Ky rezultat është në përputhje edhe me rezultatet e mëparshme mbi përhapjen e korrupsionit, i cili është përkeqësuar në vitin 2014, apo edhe me rritjen e rasteve korruptive kur dikush ka patur kontakt me një zyrtar publik. Sa më shumë njerëz të mendojnë se korrupsioni është i përhapur, aq më të prirur janë ato që të kenë pritshmëri të ulët mbi reduktimin e korrupsionit.

## 1.5 Perceptimet mbi realizueshmërinë e të politikave të korrupsionit

Të anketuarit janë pyetur për perceptimet e tyre mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit. Në vitin 2014, në krahasim me 2001 dhe 2002 rezulton se pjesa e popullsisë që mendojnë se korrupsioni mund të reduktohet ndjeshëm ose të çrrënjohet, ka ardhur në rënie. Nga ana tjetër, pjesa e popullsisë që percepton se korrupsioni nuk mund të reduktohet ndjeshëm ka qenë në rritje. Ky rezultat është në përputhje me rezultatin e mësipërm në lidhje me pritshmërinë ndaj korrupsionit.

Grafiku 19: Perceptimet mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit (%)



## II. POLITIKAT ANTIKORRUPSION DHE KUADRI RREGULLATOR

### 2.1 Strategjitë, planet e veprimit dhe programet aktuale të zbatueshme

Në qershor 2013, Shqipëria mbajti zgjedhjet kombëtare të përgjithshme, të cilat çuan në ndryshimin e partisë politike në pushtet. Gjysma e dytë e vitit 2013, ka qenë një periudhë ndryshimesh të vazhdueshme në kuadër të reformave legjislative dhe institucionale dhe fillimi i viti 2014, ndoqi të njëjtën linjë.

Në nëntor 2013 qeveria e emëroi Koordinatorin Kombëtar Kundër korrupsionit për të koordinuar aktivitetet kundër korrupsion të institucioneve shtetërore dhe institucioneve të pavarura, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Për më tepër u krijua një rrjet i pikave fokale në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura.

Strategjia e re Kundër Korrupsion (2014-2020) është përgatitur me asistencën teknike të pranisë së OSBE në Shqipëri dhe është shumë më e shkurtër dhe më e thjeshtë se strategjia e mëparshme. Kjo u bë me qëllim që strategjia të ishte një dokument më i shkurtër dhe më orientues, me objektiva të qarta dhe specifike. Strategjia dhe planet e veprimit mbeten për tu zbatuar.

#### **Disa nga risitë pozitive të Strategjisë së re:**

Një fokus i veçantë i është dhënë harmonizimit të statistikave dhe të dhënave mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar ndërmjet agjencive ligjzbatuese;

Strategjia fokusohet në tre përqsaje kryesore: parandalim, sanksionim dhe rritje e ndërgjegjësimit;

Një vëmendje më e madhe iu është vënë transparencës dhe llogaridhënies publike;

Për herë të parë strategjia ka parashikuar krijimin e kuadrit të përshtatshëm rregullator mbi "bilbilëfryrësit", i cili mungon aktualisht;

Ankesat publike janë konsideruar si një element tejet i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit;

Strategjia parashikon një vlerësim të përgjithshëm të legjislacionit mbi korrupsionin dhe institucionet e ngarkuara për zbatimin e legjislacionit kundër korrupsion, dhe një corruption proofing të legjislacionit, një praktikë e cila do të përdoret për herë të parë në Shqipëri;

Parashikohet një analizë sistematike e riskut, trendeve të korrupsionit, dhe efektivitetit të masave antikorrupsion dhe monitorim i zbatimit të tyre;

Politika anti-korrupsion në njësitë vendore/qeverisjen lokale si një prioritet: qeverisja lokale nuk duhet të shikohet si një pjesë e shkëputur nga qeverisja qendrore.

## 2.2 Zhvillimet në kuadrin rregullator

Ligji i ri i shërbimit civil, hyri në fuqi në shkurt 2014. Në mars, qeveria miratoi 10 akte nën-ligjore që trajtojnë dhe mbulojnë çështje të rëndësishme siç janë rekrutimi, transferimi, promovimi, shkarkimet nga puna, përshkrimi dhe klasifikimi i pozicionit të punës dhe stafin e ri menaxherial.<sup>1</sup>

Ligji i rishikuar **Mbi të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare**, i cili u draftua në maj, 2014 dhe kaloi në parlament në Shtator 2014<sup>2</sup>, futi sanksione administrative dhe procedura për ekzaminimin e ankesave tek Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Në Maj, 2014 kaluan në parlament dy ligje të amenduara shumë të rëndësishme: Ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"<sup>3</sup> dhe ligji "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike"<sup>4</sup>. Ligji i rishikuar rriti numrin dhe frekuencën e kontrolleve nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) dhe kërkon që zyrtarët publikë të depozitojnë pasuritë që e tejkalojnë shumën prej €10700.<sup>5</sup>

### Draf-Ligji mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik, i draftuar në Dhjetor 2013

Draft-ligji Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, i draftuar në Dhjetor 2013 dhe i aprovuar parimisht nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në shtator 2014<sup>6</sup>, parashikon detyrimin e institucioneve/organeve publike që ti japin një prioritet të veçantë konsultimit me grupet e interesit gjatë procesit të draftimit dhe aprovimit të draft-ligjeve.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër-Korrupsion, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, hartuan në maj 2014, Ligjin për bilbilfryrësit, për rastet e korrupsionit dhe të mbrojtjes ndaj tij si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Legjislacioni i ri për mbrojtjen e bilbilfryrësve, është në pritje për t'u miratuar.<sup>7</sup>

## 2.3 Ndryshimet në politikat kombëtare antikorrupsion gjatë tre viteve të fundit

Gjatë tre viteve të fundit, qeveria shqiptare ka bërë disa ndryshime në kuadër të legjislacionit mbi korrupsionin. Në mars 2012, qeveria miratoi ndryshimet ligjore që lidheshin me korrupsionin fillimisht në Kodin Penal. Këto ndryshime adresonin rastet e ryshfetit nga zyrtarët e huaj publik dhe vendosnin dënime më të ashpra në lidhje me korrupsionin në sektorin privat.

1 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)

2 [http://www.parlament.al/web/Komisioni\\_per\\_Ceshtjet\\_Ligjore\\_Administraten\\_Publike\\_dhe\\_te\\_Drejtat\\_e\\_Njeriut\\_miratoi\\_nen\\_p\\_17947\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Komisioni_per_Ceshtjet_Ligjore_Administraten_Publike_dhe_te_Drejtat_e_Njeriut_miratoi_nen_p_17947_1.php)

3 <http://www.hidaa.gov.al/ligji-nr/>

4 <http://www.hidaa.gov.al/ligji-nr-9367/>

5 [file:///C:/Users/Celsius/Desktop/SELDI%20TO%20BE%20DELIVERED/20141008-albania-progress-report\\_en%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Celsius/Desktop/SELDI%20TO%20BE%20DELIVERED/20141008-albania-progress-report_en%20(1).pdf)

6 [http://www.parlament.al/web/Komisioni\\_per\\_Ceshtjet\\_Ligjore\\_Administraten\\_Publike\\_dhe\\_te\\_Drejtat\\_e\\_Njeriut\\_miraton\\_ne\\_par\\_17902\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Komisioni_per_Ceshtjet_Ligjore_Administraten_Publike_dhe_te_Drejtat_e_Njeriut_miraton_ne_par_17902_1.php)

7 [file:///C:/Users/Celsius/Desktop/SELDI%20TO%20BE%20DELIVERED/20141008-albania-progress-report\\_en%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Celsius/Desktop/SELDI%20TO%20BE%20DELIVERED/20141008-albania-progress-report_en%20(1).pdf)

Ligji Anti-Mafia u ndryshua në mars, duke zgjeruar në këtë mënyrë sekuestrimin apo konfiskimin e pasurive të paligjshme që vijnë nga veprat penale të korrupsionit, në krimet që bien nën kompetencat e reja të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Ligji mbi Policinë e Shtetit u ndryshua në shtator 2014, ku ndër të tjera u krijua edhe Byroja Kombëtare e Hetimit, që kryen veprimtari gjurmuese dhe hetimore, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarinë kriminale të lidhur me të.<sup>8</sup>

Në mars 2014, u bënë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, ku u qartësua procedura për heqjen e imunitetit për zyrtarët e nivelit të lartë publikë dhe gjyqtarëve.<sup>9</sup>

## 2.4 Vlerësimi i kuadrit rregullator për antikorrupsionin

Ligji i parë i cili ka trajtuar çështjet korruptive është Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar në vitin 1995. Ky ligj adresoi çështje të tilla si propozime për shpërblime të bëra ndaj zyrtarëve që mbajnë një post publik, shpërdorimi i detyrës, shpërdorimi i kontributeve shtetërore, etj

Në vitin 2008, Shqipëria miratoi Ligjin mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përveç këtij ligji, ekzistojnë dhe shumë ligje të tjera që trajtojnë çështjet e korrupsionit, duke përfshirë: Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, Ligji mbi rregullat etike në administratën publike, Ligji për mbrojtjen e konkurrencës i miratuar në vitin 2003, Ligji për Prokurimin Publik, dhe Ligji për Deklarimin e Pasurive etj.

## 2.5 Ligji dhe procedura penale

Forma të ndryshme të korrupsionit janë të inkriminuara në mënyra të ndryshme në varësi të llojit të korrupsionit, ashpërsisë dhe rrethanave të tjera. Ryshfeti është forma më e përhapur e korrupsionit në Shqipëri dhe ai dënohet me një afat nga 6 muaj deri në tre vjet, ose në rast se kemi të bëjmë me kërkesë për ryshfet, kjo mund të çojë në dhënien e një dënimi deri në 12 vjet burgim, në varësi të sektorit ku kjo ndodh.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike, ndalon një punonjës të administratës publike që të pranojë dhurata, para apo shërbime nga kryerja e detyrave të tyre të shërbimit, të cilat ata duhet t'i kryejnë.

Aktualisht nuk ka rregullore apo dispozita ligjore që adresojnë klientelizmin, nepotizmin apo influencat tregtare, kështu që këto fenomene janë të përhapura në nivele të larta, sidomos kur flasim për lidhjet politike. Raporti i Konkurrencës Globale 2009-2010 gjithashtu raporton përhapjen e gjerë të favorizimeve nga zyrtarët e qeverisë, kur ata marrin vendime në lidhje me kontratat.

8 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)

9 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdfpdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdfpdf)



## 2.6 Ligji civil dhe procedurat

Shqipëria është vendi ku përqindja më e lartë e kompanive në rajon priten që të japin dhurata në mënyrë që të marrin një kontratë qeveritare (Banka Botërore dhe IFC, 2007).

Kjo situatë ka pësuar përmirësime pasi tashmë ofertat publike janë të aksesueshme në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe Shqipëria tani ka një nga sistemet më transparente të prokurimeve në rajon. Përveç kësaj, futja e sistemit online të prokurimeve (e-procurement) e përmirësoi situatën.

Në raportin e fundit të Avokatit të Prokurimeve, thuhej se ka probleme me zbatimin e kriterëve të seleksionimit dhe sipas Raportit të fundit të Shtetit në 2011, prokurimet publike cilësohen si sektori më me shumë raste problematike të lidhura me abuzimet. Sipas progres raportit të vitit 2013 të Komisionit Evropian, thuhet se pavarësisht pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, Ligji për Gjykatën e Lartë, i cili hyri në fuqi në 1 tetor, rriti numrin e gjyqtarëve nga 17 në 19 me qëllim, ndër të tjera, edhe ngritjen e një Dhome Administrative për të vepruar në mënyrë më efektive me ngarkesën e punës së Gjykatës. Ligji gjithashtu paraqet kushte dhe kriterë më strikte për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe zvogëlon komponentin jo-gjyqësor të anëtarësimit të Gjykatës në një maksimum prej një të katërtën, duke përforcuar karakterin profesional të Gjykatës së Lartë.

## 2.7 Legjislacione të tjera që luftojnë korrupsionin

### • Bilbilfryrësit

Qeveria shqiptare ka hartuar një ligj të ri për bilbilfryrësit, i cili pritet që të kalojë në parlament brenda vitit 2014.<sup>10</sup>

### • Konflikti i interesave

Ligji i cili mbulon çështjet e konfliktit të interesave është Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike, i ndryshuar me Ligji nr. 44/2014 datë 24.04.2014, i cili ka për qëllim që të sigurojë një proces vendimmarrje sa më transparent dhe të paanshëm, në interes të publikut si dhe të besimit të tij në institucionet publike, nëpërmjet parandalimit të konflikteve midis interesave publike dhe private të një zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

Legjislacioni për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve publikë dhe të konfliktit të interesit, është argumentuar nga qeveria e re për të paraqitur problemet me një natyrë legjislative dhe administrative, por gjithsesi akoma nuk ka asnjë informacion faktik apo statistika mbas këtyre masave.

### Rekomandime

Qeveria ka identifikuar disa objektiva, me qëllim adresimin e problemeve në legjislacion, në mënyrë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Një nga këto është rishikimi i legjislacionit për ndjekjen penale të korrupsionit financiar. Korrupsioni financiar mund të konsiderohet një krim ekonomik dhe të ardhurat që sigurohen nga praktikat korruptive financiare, kryesisht investohen jashtë Shqipërisë, gjë e cila rrit nevojën e rritjes së bashkëpunimit midis subjekteve ekzekutive lokale me subjektet ekzekutive të huaja, në mënyrë hetimin e krimit financiar. Për më tepër, të gjitha institucionet publike duhet të hartojnë draft-ligje që përdorin metodologjinë e corruption proofing of legislation.

### III. PRAKTIKAT INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI I LIGJIT

#### 3.1 Mekanizmat antikorrupsion në legjislacion

Aktualisht në parlament nuk ka një Komision për Antikorrupsionin por çështjet e korrupsionit dhe antikorrupsionit përfshihen në komisionet e tjera parlamentare. Në lidhje me rregullat e anëtarëve të parlamentit, aktualisht nuk ka një kod të shkruar gjithëpërfshirës për anëtarët e parlamentit. Gjithsesi, ekziston një Rregullore e Parlamentit në Republikën e Shqipërisë, e cili përmban pikat si më poshtë: mënyra e organizimit dhe funksionimit të parlamentit, procedurat, kontrolli parlamentar, transparencja e aktiviteteve parlamentare, emërimet, zgjedhjet dhe shkarkimet e organeve, interpretimi, ndryshimet e rregullave dhe heqja e imunitetit, shërbimet parlamentare.<sup>11</sup>

Transparenca e procesit legjislativ është rritur. Janë bërë përmirësime në kuadrin e përfshirjes së shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin legjislativ<sup>12</sup>. Në lidhje me dispozitat ligjore kundër korrupsionit në lidhje me financimin e partive politike, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratoi me referendum në vitin 1998, në nenin 9/3 i cili parashikon se "burimet financiare të partive politike dhe shpenzimet e tyre duhet të jetë gjithmonë publike". Ky është një parim shumë i rëndësishëm si për paratë ashtu edhe për politikën që të gjitha burimet financiare dhe mënyrën sesi partitë politike i përdorin ato për qëllime elektorale, duhet gjithmonë të bëhen publike. Ligji "Për partitë politike", Nr. 8580, datë 17.2.2000, në Kapitullin II, Neni 17 parashikon që partitë politike kanë burime financiare dhe materiale, në mënyrë që të realizojnë qëllimet dhe aktivitetet e tyre.

#### 3.2 Roli i organeve kombëtare në luftën kundër korrupsionit

Në lidhje me luftën kundër korrupsionit, ekzistojnë disa struktura të listuara si më poshtë:

Avokati i popullit i cili ka për qëllim dhënien e rekomandimeve dhe propozimin e masave gjatë vëzhgimit të dhunimit të të drejtave njerëzore nga ana e administratës publike. Në lidhje me çështjet më të zakonshme shqetësuese në Shqipëri, rezultojnë të jenë: ankesat e qytetarëve për abuzimin e pushtetit nga ana e policëve, mungesa e zbatimit të vendimeve gjyqësore për çështjet civile, dhe mosmarrëveshjet e pronave.<sup>13</sup> Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është institucioni i cili merret me mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik, në mënyrë të veçantë me: monitoron ekzekutimin e procedurave të prokurimit publik, paraqet propozime për rregullat e prokurimit në Këshillin e Ministrave, promovon dhe organizon trajnimin e zyrtarëve të qeverisë qendrore dhe vendore që merren me aktivitetet e prokurimit publik, redaktimet dhe çështjet e Buletinit të Prokurimit Publik, etj.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është një organ shtetëror specifik pothuajse gjyqësor, i cili ka kompetencën për të ofruar mbrojtje ligjore në prokurimin publik. KPP është themeluar nga Ligji i Prokurimit Publik, si organi më i lartë në sistemin e prokurimit, i cili siguron mbrojtje ligjore për tenderët dhe interesin publik në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik, koncesioneve, ankandëve dhe licencat e minierave.

11 [http://www.parlament.al/web/Parliament\\_adopts\\_the\\_draft\\_decision\\_On\\_some\\_changes\\_to\\_the\\_decision\\_no\\_166\\_dated\\_16\\_12\\_2004\\_10678\\_2.php](http://www.parlament.al/web/Parliament_adopts_the_draft_decision_On_some_changes_to_the_decision_no_166_dated_16_12_2004_10678_2.php)

12 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/albania\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/albania_2013.pdf)

13 Global Integrity, 2010

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI) është themeluar në vitin 2003 si një organ i pavarur, i cili është përgjegjës për mbledhjen e deklaratave të pasurive të zyrtarëve publikë dhe identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit. Shqetësimi kryesor i Inspektoratit është të identifikojë informacionin e gabuar ose mashtrues, në deklaratat e tyre.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) i Republikës së Shqipërisë është themeluar në vitin 1992 si një institucion parlamentar i pavarur nga qeveria. Kur Akti i Auditimit u miratua në dhjetor të vitit 1997, institucioni u bë një autoritet kolegjial që qeverisej nga një bord prej tre anëtarësh. Në fund të vitit 1998, u miratua Kushtetuta aktuale, por dispozitat e saj nuk tregojnë tipin e Institucionit të Kontrollit të Shtetit ashtu siç duhet të jenë (një model i gjykatës apo një zyrë model). Pas amendimit të fundit të Aktit të Auditimit të 1997, në prill 2000, Institucioni i Kontrollit të Shtetit, është tani një përbërje monokratike, modeli zyre, institucion kontrolli. Riorganizimi i brendshëm u zhvillua në përputhje me rrethanat. Aktivitetet e kontrollit janë duke u udhëhequr nga kryetarët e të katër departamenteve të auditimit.<sup>14</sup>

### 3.3 Administrata e përgjithshme publike

Ligji Nr 90,152 / 2013 mbi Nënpunësin Civil, ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm, bazuar në merita, integritetin moral, paanësisë politike dhe llogaridhënies. Ai rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet shteteve dhe nëpunësve civilë dhe përcakton rregullat e menaxhimit të shërbimit civil.

Në lidhje me deklarin e gjendjes financiare dhe deklarimin e pronës, ekziston një ligj i veçantë: Ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", Nr. 9.49, datë 10 Prill 2003. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, familjet e tyre dhe personat e lidhur me ta.

Gjithashtu, ekziston Ligji nr. 9131 i datës 8 shtator 2003 mbi "Rregullat e Etikës në Administratën Publike", i cili synon vendosjen e rregullave të sjelljes së punonjësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, në mënyrë që ti ndihmojë ato arritjen e standardeve dhe për të bërë të vetëdijshëm publikun mbi sjelljet që duhet të ketë një punonjës i administratës publike.

Ligji kundër nepotizmit u miratua në vitin 2004; megjithatë, ai u konsiderua menjëherë antikushtetues dhe kështu ai u shfuqizua.<sup>15</sup> Këtë vit u bë rishikimi i ligjit për statusin e nëpunësit civil (Ligji nr 8549, datë 11.11.1999). Ai u miratua nga parlamenti në vitin 2013, por zbatimi i tij u shty për vitin 2014.

### 3.4 Zbatimi i ligjit

Policia luan teorikisht një rol të rëndësishëm në zbatimin e ligjit. Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, punonjësit e policisë nuk e zbatojnë ligjin në mënyrë të barabartë. Korrupsioni dhe imuniteti në radhët e Policisë së shtetit, është një problem i vazhdueshëm, e ndikuar kjo dhe nga pagat e ulëta të punonjësve të policisë.

14 Masat Anti-Korrupsion në Evropë Jug-Lindore, Rishikime të vendit dhe prioritetet për reforma, Stability Pact Anti-Corruption Initiative

15 <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/europe-central-asia/albania/show-all.aspx>

Barometri i korrupsionit global i Transparency Internacional nxjerr në pah se familjet shqiptare e cilësojnë Policinë e Shtetit si një nga institucionet më të korruptuara në vend.<sup>16</sup>

Qeveria e re ka vendosur si prioritet përdorimin e policisë së shtetit si një faktor kyç në luftën ndaj korrupsionit. Ligji për policinë e shtetit u ndryshua gjate muajit Shtator të 2014.

Me qëllim parandalimin dhe hetimin e krimeve të korrupsionit dhe të korrupsionit të brendshëm, ekzistojnë disa struktura të listuara si më poshtë:

Autoriteti i Forcës si Sigurisë Portuale e cila vepron në bashkëpunim me Kodin Ndërkombëtar për Sigurinë e Anijeve dhe Porteve, Organizata Ndërkombëtare Detare (OND), konventën SOLAS, 74, i ndryshuar në bazë të ligjit nr. 9281 "Për sigurinë e anijeve dhe porteve", i datës 09.23.2004 dhe me akte të tjera ligjore që janë në fuqi.

Departamenti i Kufirit dhe Migracionit i cila është në varësi të Drejtorisë së përgjithshme të Mbrojtjes. Ajo është zyrtarisht përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e kufirit, kontrollin e lëvizjes së njerëzve, automjeteve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror.

Departamenti i Investigimit dhe Operacioneve, i cila është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ai përbëhet nga Departamenti i Zbatimit, Departamenti i Anti-trafikut, Drejtoria e Investigimit, Departamenti i Kontrollit pas Zhdoganimit, Drejtoria e Informacionit, Drejtoria e Analizimit të Riskut dhe Departamenti i Pronësisë Intellektuale.

Byroja Kombëtare e Investigimit e cila është një strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit, e cila kryen aktivitete investiguese në përputhje me ligjin dhe procedurat për krimet, mbi krimet në lidhje me korrupsionin dhe aktivitetet kriminale.<sup>17</sup>

Njësia e Antitrafikut operon në bazë të vendimit të kryeministrit, nr 203 i datës 19/12/2005 e cila monitoron aktivitetin e institucioneve që merren me implementimin e strategjisë kombëtare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, koordinon punët me këto institucione etj.<sup>18</sup>

### 3.5 Indikatorët sasiorë për zbatimin e dispozitave të ligjit antikorrupsion

Burimi kryesor i informacionit statistikor, janë Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Marrëdhëniet me këto institucione, së bashku me detyrimet ligjore nga ana e ligjit mbi "Organizimin e Gjyqësorit" dhe ligjit mbi "Prokurorinë", janë rregulluar nëpërmjet akteve rregullatore si urdhrat dhe udhëzimet e Ministrit të Drejtësisë. Një burim tjetër i rëndësishëm statistikor që shërben për të reflektuar të dhënat e siguruara nga hetimet paraprake dhe dinamikën e tyre, janë evidencat statistikore që sigurohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, ekzistojnë edhe burime të tjera që mund të përdoren për të siguruar të dhëna siç mund të jetë INSTAT.<sup>19</sup>

16 <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/europe-central-asia/albania/corruption-levels/police.aspx>

17 [http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents\\_files/LIGJI\\_I\\_POLICISE\\_SE\\_SHTETIT\\_-\\_2014.pdf](http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/LIGJI_I_POLICISE_SE_SHTETIT_-_2014.pdf)

18 [http://www.dsd.gov.al/dsd/pub/crosscutting\\_str\\_fight\\_against\\_organised\\_crime\\_177\\_1.pdf](http://www.dsd.gov.al/dsd/pub/crosscutting_str_fight_against_organised_crime_177_1.pdf)

19 <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>

Në tabelën si më poshtë jepen të dhëna në lidhje me çështjet e korrupsionit dhe antikorrupsionit.

Tabela 1: Numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga Gjykatat e Shkallës së Parë

Numri i padive të përfunduara nga gjykimi	2007	2008	2009	2010	2011
	41,818	50,714	59,060	53,106	61,696

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Raportet vjetore:  
<http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>

## Rekomandime

Shqipëria ka nevojë që t'i kushtojë një vëmendje të veçantë, zbatimit të reformës së administratës publike, në veçanti në lidhje me ligjet strukturore dhe aktet administrative. Legjislacioni sekondar për Ligjin e ri të Shërbimit Civil duhet të miratohet dhe të zbatohet me shpejtësi.

Kapaciteti parandalues dhe represionues dhe pavarësia e institucioneve që merren me zbatimin e ligjit, kanë nevojë që të rritet. Gjithashtu, duhet që të sigurohet një ndjekje efektive nga ana e parlamentit, e raporteve të realizuara nga institucionet e pavarura. Një ndër sfidat afatshkurtra është rritja e hetimeve proaktive bazuar në vlerësimin sistematik të rrezikut, si një parakusht për ndërtimin e një historie të ndjekjes penale efektive në të gjitha nivelet, sidomos në ato zona ku ka një perceptim të fortë publik për korrupsion. Në këtë aspekt, mbeten akoma dobësi që duhen përmirësuar çështje të tilla si: bashkëpunim i dobët ndër institucional, mungesa e burimeve njerëzore dhe planifikim i dobët i buxhetit dhe alokimit të tij. Shqipëria duhet që të bëjë një rishikim të strategjisë së saj të reformës gjyqësore dhe të nxisë më tej pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve të saj gjyqësore. Në përgjithësi, hetimet vazhdojnë të kenë më shumë një natyrë reaktive sesa proaktive si dhe natyra dhe vlerësimi i korrupsionit nuk kryhen në mënyrë sistematike. Institucionet shtetërore që merren me luftën kundër korrupsionit mbeten të ndjeshme ndaj presionit dhe ndikimit politik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar kritere transparente dhe në bazë të meritave për emërime dhe shkarkime.

## IV. ROLI I GJYQËSORIT NË ANTIKORRUPSION

### 4.1 Statuti i gjyqtarëve

Bazuar në Ligjin Nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e sistemit gjyqësor në republikën e Shqipërisë"<sup>20</sup> dhe Nenin 135, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, gjyqësori në Shqipëri ushtrohet nga Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkallës së parë. Procedurat disiplinore kundër gjykatësve kanë çuar në vënien e një sërë sanksionesh. Megjithëse ka rregullat për pezullimin dhe shkarkimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë shfaqur shqetësime mbi miratimin e tyre në një kohë të shpejtë, pa u konsultuar paraprakisht me të gjithë aktorët përkatës.

Gjyqtarët e gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit<sup>21</sup>

Për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Apelit, të Shkallës së Parë dhe të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, merren në konsideratë një tërësi kriteresh. Shtetasit shqiptarë mund të emërohen si gjyqtarë në këto gjykata, nëse ata plotësojnë kriteret e përgjithshme si në vijim: të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të ketë arsim të lartë juridik, të jetë i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, etj.

Gjyqtarët e Gjykatës së Krimeve të Rënda (pjesë e Gjykatave të Shkallës së parë) duhet të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në Gjykatat e Shkallës së parë, duhet të ketë qenë i shquar për aftësi profesionale dhe të kenë vlera të larta etike-morale, duhet të kenë qenë vlerësuar me një notë "shumë mirë" për aftësitë e tyre profesionale në të dy vlerësimet e fundit, dhe nuk duhet të ketë asnjë veprim disiplinor kundra tyre dhe që është ende në fuqi.

Emërimi i gjyqtarët të Gjykatës së Apelit, duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret emërimi, përveç kësaj, gjyqtarët duhet të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në Gjykatat e Shkallës së Parë, në mënyrë që të kenë mundësi të emërohen në Gjykatat e Apelit.

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë<sup>22</sup>

Për t'u zgjedhur si gjykatës në Gjykatën e Lartë, çdo aplikant duhet të ketë diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë dhe duhet të ketë punuar ose si gjyqtar për jo më pak se 13 vjet, nga të cilat të paktën, 5 vjet duhet të ketë punuar si gjyqtar në Gjykatat e Apelit, apo në një nga të mëposhtmet: jurist me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale në funksionet e administratës publike të Kuvendit, administratën e Presidencës, Këshillit të Ministrave, në ministri dhe institucione të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe të Lartë; prokurori; avokat; dhe pedagog apo profesor me një diplomë akademike "Doktor i Shkencave", apo drejtor dhe pedagog në Shkollën e Magjistraturës.

20 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 135, i rimarrë në Janar 2013 ([http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta\\_a\\_perditesuar\\_15171\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_a_perditesuar_15171_1.pdf))

21 Kriteret e selektimit të gjyqtarëve në Gjykatat e Apelit dhe ato të Shkallës së Parë janë të specifikuar në Nenin 11, Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e Gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë", për më shumë informacion referojuni Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008,

([http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni\\_Brendshem\\_Web/LIGJI\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_PUSHTETIT\\_GJYQESOR.pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/LIGJI_PER_ORGANIZIMIN_E_PUSHTETIT_GJYQESOR.pdf))

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Emërimi i Gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit, sicc u pa në Janar 2014, ([http://www.gjykata.gov.al/portal\\_main/Kushtet.aspx](http://www.gjykata.gov.al/portal_main/Kushtet.aspx))

22 Kriteret dhe procedura e emërimit të gjykatësve në Gjykatën e Lartë, janë të përcaktuara në Ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë në republikën e Shqipërisë", për më shumë informacion referojuni; Ligji nr. 8588, datë 15.03.2000, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë në republikën e Shqipërisë",

[http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni\\_Brendshem\\_Web/LIGJI\\_PER\\_GJYKATEN\\_E\\_LARTE.pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/LIGJI_PER_GJYKATEN_E_LARTE.pdf)  
Në lidhje me disa ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 (<http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:151/2013:30.05.2013>)

Përveç këtyre kritereve të përgjithshme, duhet të theksojmë se ligji për Gjykatën e Lartë, iu është nënshtruar Ligjit të vitit 2013 në lidhje me kriteret e emërimit, duke ndjekur në të njëjtën kohë rekomandimet e EURALIUS III dhe UNIFEM,<sup>23</sup> për të adresuar çështjet e "konfliktit të interesit" që interferojnë me emërimet e gjykatësve në Gjykatën e Lartë.

## 4.2 Dispozitat ligjore dhe strukturat që merren me korrupsionin midis magjistratëve

### Dispozitat ligjore

Neni 32 pika d) e ligjit numër 9877, "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" përcakton masat disiplinore dhe dispozitat ligjore në lidhje me korrupsionin në mesin e gjyqtarëve në Shqipëri. Sipas këtij neni, "përfitimet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë: dhurata, favore, premtime ose trajtime të veçanta, të dhënë për shkak të detyrës", konsiderohen shkelje të rënda disiplinore.<sup>24</sup>

### Inspektorati gjyqësor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë

Në lidhje me strukturat që merren me trajtimin e korrupsionit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përveç faktit që është përgjegjës për emërimin, transferimin, shkarkimin, dhe edukimin e gjykatësve, po ashtu përfshin vlerësimin moral dhe profesional, si dhe kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve të gjyqtarëve të gjykatave e Shkallës së Parë dhe të Gjykatave të Apelit. Në korrik, ndryshimet e Ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Ligji mbi Gjykatat Administrative dhe Ligji për Shkollën e Magjistraturës janë miratuar në mënyrë të shpejtë, jashtë një procesi gjithëpërfshirës të reformës bazuar në konsultime të gjera dhe nën drejtimin e Komisioni të Venices.<sup>25</sup>

### Inspektorati gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë

Ka një debat të rëndësishëm që lidhet me faktin nëse kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Inspektorati mbivendosen me kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit gjyqësor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kjo ka sjellë paqartësi në lidhje me detyrat që secili prej këtyre inspektorateve duhet të ketë, dhe si pasojë ka sjellë një monitorim të paqartë dhe të pakoordinuar të gjyqësorit. Gjithashtu duket se Ministria e Drejtësisë nuk duhet të ndërhyjë, monitorojë dhe vlerësojë sistemin gjyqësor, sepse ekzekutivi dhe gjyqësori duhet të qëndrojnë të ndara për të siguruar pavarësinë e këtij të fundit dhe të zvogëlojë ndikimin që ekzekutivi mund të ketë në gjyqësor. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga ana tjetër është një organ i pavarur, i ndarë nga qeveria, e cila mund të mbikëqyrë dhe monitorojë gjyqësorin.

23 OSFA Monitoring Report on Implementation of the Justice Reform, 2013, (<http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/Ersida/Ra->

24 [http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/Ersida/Ra-porti%20i%20Monitorimit%20te%20Strategjise%20%20se%20Drejtises/Raporti%20per%20monitorimin%20e%20Strategji%20se%20Ndersektoriale%20te%20Drejtises\\_2012.pdf](http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/Ersida/Ra-porti%20i%20Monitorimit%20te%20Strategjise%20%20se%20Drejtises/Raporti%20per%20monitorimin%20e%20Strategji%20se%20Ndersektoriale%20te%20Drejtises_2012.pdf))

Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, Neni 32 pika d). ([http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni\\_Brendshem\\_Web/LIGJI\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_PUSHTETIT\\_GJYQESOR.pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/LIGJI_PER_ORGANIZIMIN_E_PUSHTETIT_GJYQESOR.pdf))

25 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)

### 4.3 Dispozitat ligjore për imunitetin dhe mbrojtja kundër largimit nga puna

Në Mars, u bë miratimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, duke zbatuar ndryshimet kushtetuese të vitit 2012, mbi kufizimet për imunitetet që gëzojnë gjyqtarët, deputetët dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Një shqyrtim i gjerë i kodit është ende në proces.<sup>26</sup>

Në përgjithësi, gjyqtarët nuk mund të shkarkohen nga puna nëse nuk japin dorëheqjen, nuk kanë arritur moshën e pensionimit (65 vjeç), nuk janë dënuar nga gjykata, apo nuk janë fizikisht ose mendërisht të aftë, apo nuk janë profesionalisht të aftë. Në rast pushimi nga puna, gjyqtari ka të drejtë të ankohet brenda 15 ditëve nga data që është lëshuar ky njoftim vendimi, në Gjykatën e lartë.<sup>27</sup> Në qoftë se atyre iu është dhënë një masë disiplinore, ata kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Apelit në Tiranë.<sup>28</sup>

### 4.4 Statistikat mbi procedurat disiplinore kundër korrupsionit

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë publikon një raport vjetor që përmban një përmbledhje të të gjitha statistikave që kjo ministri ka mbledhur gjatë një viti të caktuar (viti i raportimit). Tabela 2 ofron një pasqyrë të numrit të gjyqtarëve/prokurorëve/zyrtarëve të tjerë të dënuar, si pasojë e ushtrimit të korrupsionit aktiv ose pasiv, për periudhën 2004-2012. Nuk ka raste të regjistruara në vitin 2012, dhe numri më i lartë i gjyqtarëve të dënuar, të akuzuar për krime të korrupsionit është regjistruar në vitin 2011, me 5 autorë të dënuar për praktikimin e korrupsionit aktiv, dhe 1 për pranimin e korrupsionit pasiv.

Tabela 2: Numri i të dënuarve për krime kundër Drejtësisë, Republika e Shqipërisë 2004-2012

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë në drejtësi	0	0	0	0	0	0	1	5	0
Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë në drejtësi	0	0	0	0	0	1	0	1	0

Burimi: Ministria e Drejtësisë, <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>

### 4.5 Kodi i etikës/sjelljes

Në Shqipëri, ekziston një Kod i Etikës për gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë që adreson çështjet madhore siç janë konflikti i interesave, komunikimi midis gjykatave dhe aktivitetet e papërshtatshme politike.

26 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)  
 Ligji nr 8588, datë 15.3.2000, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës së Lartë në republikën e Shqipërisë" [http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni\\_Brendshem\\_Web/LIGJI\\_PER\\_GJYKATEN\\_E\\_LARTE.pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/LIGJI_PER_GJYKATEN_E_LARTE.pdf)  
 Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, ([http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni\\_Brendshem\\_Web/LIGJI\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_PUSHTETIT\\_GJYQESOR.pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/LIGJI_PER_ORGANIZIMIN_E_PUSHTETIT_GJYQESOR.pdf))



Kodi i Etikës Gjyqësore është zbatuar më 5 Dhjetor 2000. Sipas tij, të gjithë gjyqtarët duhet t'u përmbahen rregullave të tyre; përndryshe ata do të jenë përgjegjës para Këshillit Ekzekutiv të Konferencës Gjyqësore Kombëtare (KGJK). Të gjitha shkeljet shqyrtohen nga Komiteti Disiplinor i KGJK dhe mund të rezultojnë në dhënien e vërejtjes.<sup>29</sup>

Sipas Ligjit të rishikuar Numër 77, datë 26.07.2012,<sup>30</sup> KGJK është shoqata e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Gjykatave të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, dhe konsiderohet si person juridik publik. Ajo mban mbledhje vjetore dhe zgjedh 9 nga 14 gjyqtarët për Këshillin e Lartë të Drejtësisë nga mbledhja e gjyqtarëve të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë.<sup>31</sup> Deri tani, vetëm gjyqtarët që u diplomuan nga Shkolla e Magjistraturës janë të nevojshëm për të kaluar një kurs një semestral mbi Etikës Gjyqësore përpara se të emërohen. Për më tepër, nuk ka asnjë kërkesë për gjyqtarët në detyrë të cilët nuk janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për t'u kualifikuar në lidhje me Kodin e Etikës. Sipas Progres-Raportit të Komisionit Evropian 2013, zbatimi i këtij Kodi nuk është në nivelet e pritshme, prandaj pritet një zbatim më efektiv i tij.<sup>32</sup>

Për sa i përket gjykatave antikorrupsion, duhet theksuar se në Shtator 2014 u krijua një njësi e re e quajtur Seksioni i Hetimit të Korrupsionit dhe pasurive të Zyrtarëve<sup>33</sup>, në Prokurorinë e Krimeve të rënda që ka për qëllim për të hetuar rastet e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të lartë.

Tabela 3: Numri i të akuzuarve dhe të dënuarve për krimet e korrupsionit, 2010-2011

	■ Nr. i të akuzuarve		■ Nr. i të dënuarve	
	■ 2010	■	■ 2011	■
Marrja e shpërblimeve ekstra për zbatimin e procedurës	0	0	0	0
Korrupsioni aktiv privat	0	0	0	0
Korrupsioni pasiv privat	10	15	2	2
Korrupsioni aktiv i personave që mbajnë një post publik	7	0	2	4
Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë	7	5	3	5
Përpjekja për të impaktuar në mënyrë jo ligjore njerëz që mbajnë poste publike	22	13	11	19
Korrupsioni pasiv i personave që mbajnë një post publik	66	11	12	39
Korrupsioni pasiv i zyrtarëve të lartë	2	1	0	1
Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit	0	2	1	0
Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit	1	0	2	0
Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit	5	2	1	2
Dhënia e kompensimeve ekstra (jo ligjore)	0	0	0	0

Burimi: Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi situatën e kriminalitetit në Shqipëri", 2011: <http://www.pp.gov.al/>

29 American Bar Association, "Iniciativat e Shtetit Ligjor" 2008, Indeksi i Reformës Gjyqësore në Shqipëri, Volumi IV ([http://www.americanbar.org/content/dam/aba/directories/roli/albania/albania\\_jri\\_iv\\_12\\_2008\\_al.authcheckdam.pdf](http://www.americanbar.org/content/dam/aba/directories/roli/albania/albania_jri_iv_12_2008_al.authcheckdam.pdf))

30 Ligji Nr. 77, datë 26.07.2012, (<http://mobile.ikub.al/LIGJE/PeR-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSION-IMIN-E-KONFERENCES-GJYQESORE-KOMBETARE-1209070091.aspx>)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ([http://www.parlament.al/web/Kushtetuta\\_e\\_Republikes\\_se\\_Sh-qiperise\\_e\\_perditesuar\\_1150\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Sh-qiperise_e_perditesuar_1150_1.php))


31 qiperise\_e\_perditesuar\_1150\_1.php)

32 age/al\_rapport\_2013.pdf)

33 <http://www.pp.gov.al/>

Bazuar në raportin vjetor të Ministrisë së Drejtësisë (2004-2011) numri i njerëzve të dënuar për shpërdorim të detyrës, ka patur një trend jo të qëndrueshëm. Në periudhën e marrë në konsideratë në vitin 2009 duket se është dënuar numri më i madh i njerëzve

Grafiku 20: Numri i të dënuarve për shpërdorimin e detyrës (2004-2011)



Burimi: Ministria e Drejtësisë:

Raportet vjetore. <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>

Sipas nenit 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, prokuroria nuk është pjesë e gjyqësorit. Zyrat e prokurorëve janë të vendosura në gjykatat, por ato konsiderohen të jenë organe të pavarura që mbrojnë drejtësinë, duke hetuar dhe ndjekur lloje të ndryshme të krimeve dhe korrupsionit, shkeljet e të drejtave të njeriut etj.

Në zyrat e prokurorëve, duhet të theksojmë se ka mjaftueshëm njësi të specializuara për korrupsionin, të listuara si më poshtë:

Njësia e Përbashkët Hetimore për Luftën Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit: Në maj 2007, Prokurorja e Përgjithshme, Ministri i Punëve të Brendshme, dhe strukturat tjera, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi për të formuar këtë njësi, e cila ka për qëllim përmirësimin e hetimit dhe ndjekjen penale të korrupsionit publik dhe krimeve të tjera financiare.

Drejtoria e Krimit të Organizuar dhe Ekonomik- Kjo drejtori është një njësi e brendshme e zyrës së Prokurorisë së përgjithshme. Drejtoria ka mandatin për të ndjekur penalisht rastet e korrupsionit të cilat më pas i raporton tek Prokurori i Përgjithshëm.<sup>35</sup>

Departamenti i Krimit ekonomik dhe korrupsionit i cili u krijua në vitin 2005, me qëllim futjen e ndjekjes penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Ky departament është nën drejtimin e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Prokurorit të Përgjithshëm në Gjykatën e rrethit të Tiranës.<sup>36</sup>

34 Masat Anti-Korrupsion në Evropën Jug-Lindore, Rishikimet e vendit dhe prioritetet për Reformë, Stability Pact Anti-Corruption Initiative

35 <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/europe-central-asia/albania/initiatives/public-anti-corruption-initiatives.aspx>

36 <http://www.pp.gov.al/>

**Rekomandime:**

Duhet të ndërmerren masa për të siguruar transparencë në emërimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve, në bazë të kriterëve dhe në bazë të meritave. Është e nevojshme vendosja e kriterëve të qarta dhe specifike në lidhje me përzgjedhjen e cila bazohet në meritë dhe parime profesionale, në këtë mënyrë do të reduktohen nepotizmi, klientelizmi dhe format e tjera të korrupsionit gjyqësor.

Së dyti, pushteti gjyqësor ka qenë i prirur për t'u ndikuar nga pushteti ekzekutiv, gjë që ul kredibilitetin e këtij të fundit në sytë e publikut. Depolitizimi dhe sigurimi i pavarësisë së gjyqësorit është e nevojshme për gjyqësorin për të fituar më shumë besim dhe për të vepruar në mënyrë të pavarur. Roli dhe pavarësia e Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të forcohet, për aq kohë sa Këshilli është përgjegjës për të siguruar integritetin e gjyqësorit në Shqipëri duke monitoruar dhe vlerësuar atë.

Inspektorati në KLD duhet të luajë një rol primar në monitorimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve, sepse ai nuk është i lidhur me pushtetin ekzekutiv dhe përbëhet nga gjyqtarë me përvojë, dhe duke qenë aq afër funksionit të Gjyqësorit mund të bëjë një monitorim dhe vlerësim akoma më të mirë. Për më tepër, duke i caktuar një pushtet më të madh Inspektoratit në KLD, kjo e fundit mund të ketë detyra dhe përgjegjësi të qarta, dhe do të jetë përgjegjëse për përmbushjen efektive të tyre.

Format e korrupsionit në gjyqësor si: ryshfeti, shpërblimet shpesh, etj. mund të reduktohen nëse autoritetet mbikëqyrëse/monitoruese luajnë një rol më vendimtar dhe në qoftë se publiku ka më shumë besim në fuqinë dhe autoritetin e tij.

Gjithashtu, Konferenca Kombëtare Gjyqësore, që zgjedh 9 nga 14 anëtarët e Gjykatës së Lartë, duhet të jetë më aktive dhe kërkuese për shkak se ajo paraqet pikëpamjet e gjyqtarëve të të gjitha niveleve dhe për këtë arsye, ajo ka mbrojtje edhe më të madhe kundër partiave.

Së treti, duhet të mbahet në vëmendje se kufizimi i imunitetit të gjyqtarëve është një masë e mirë, e cila duhet të reflektohet edhe në numrin e padive nga ana e prokurorëve që tashmë mund të hetojnë dhe të nisin ndjekjen, pa patur një autorizim paraprak.

## V. KORRUPSIONI DHE EKONOMIA

### 5.1 Korrupsioni politik

Korrupsioni politik mbetet një problem i madh në Shqipëri i cili manifestohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë por jo vetëm, marrëdhëniet e fshehta, patronazhin, nepotizmin dhe nderet, evazionin fiskal, shantazhet ose ndikimet mbi zbatimin selektiv të rregulloreve të veçanta. Favorizimet e paligjshme e disa organizatave apo bizneseve të veçanta, shpërdorimi i fondeve publike, lobimi për zbatimin e rregulloreve/ligjeve selektive në dëm të konkurrentëve etj, duhen minimizuar përmes bërjes më transparente të shpenzimeve publike duke adresuar disa ndryshime në legjislacion për rregulla më të mira mbi financimin dhe lobimin politik. Këto mund të çojnë në favorizime të paligjshme dhe konflikt interesi; sanksionimin e sjelljeve anti-konkurrese të kompanive private, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së organeve të qeverisë për qytetarët.

### 5.2 Korrupsioni dhe mjedisi i biznesit

Efektet e korrupsionit politik në ekonominë shqiptare, zakonisht manifestohen në formën e shpërdorimit të kanalizimit të fondeve publike, nëpërmjet marrëveshjeve të prokurimit dhe të koncesionit publik për të favorizuar politikisht bizneset dhe organizatat ose bizneset që ofrojnë pagesa të larta të paligjshme, në formën e evazionit fiskal për kompani të caktuara, zbatimin selektiv të rregulloreve të veçanta, etj. Në vitin 2014 Shqipëria renditet në vendin e 54, me një liri ekonomike të përgjithshme 66.9 pikë, dhe me një rezultat prej 30.4 për lirinë nga korrupsioni.<sup>37</sup> Shqipëria është 9.6 pikë nën mesataren botërore, dhe liria nga korrupsioni është komponenti i dytë më i keq i indeksit të përgjithshëm të lirisë ekonomike, pas lirisë së punës.

Tabela 4: Liria nga korrupsioni <sup>38</sup>

VITI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PIKE	10	25	25	25	24	26	29	34	32	33	31	30.4
RENDITJA	128	107	107	115	127	108	107	86	95	89	93	101

Burimi: Heritage Foundation (2014), Indeksi i Lirisë Ekonomike, Shqipëri

Një tjetër tregues që mund të ofrojë një përafrim të korrupsionit, si dhe të kapjes së shtetit nga elitat, është Kontrolli i Korrupsionit, nga Treguesit Botërorë të Qeverisjes (WGI), i cili reflekton perceptimet e masës në të cilën ushtrohet pushteti publik për përfitime private, duke përfshirë format e vogla dhe të mëdhaja të korrupsionit, si dhe "kapjen" e shtetit nga elitat dhe interesat private.<sup>39</sup> Vlerat në tabelën e mëposhtme japin vlerësime të qeverisjes të cilat shkojnë nga -2.5 (i dobët) deri në 2.5 (fortë) të performancës së qeverisjes, dhe përfshijnë periudhën kohore 1996-2012.

37 Vlerësimet janë të bazuara në një shkallë nga 0 deri në 100, me 0 e cila përfaqëson lirinë më të vogël, ndërsa 100 lirinë më të madhe

38 Heritage Foundation (2014), Index of Economic Freedom, Albania. <http://www.heritage.org/index/visualize?countries=albania&type=9> (Accessed in May 2014).

39 World Bank (2012), Worldwide Governance Indicators (WGI). Mund të gjendet në: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>

\* Ato janë bazuar në 32 burime individuale të të dhënave që janë të prodhuara nga disa institute sondazhesh, think tanks, organizata jo-qeveritare, organizata ndërkombëtare dhe firma të sektorit privat. performancës së qeverisjes, dhe përfshijnë periudhën kohore 1996-2012.

Tabela 5: Kontrolli i Korrupsionit, Shqipëri

VITI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
PIKET	-0.77	-0.67	-0.75	-0.81	-0.66	-0.55	-0.49	-0.49	-0.65	-0.72

Burimi: Banka Botërore (2012), Indikatorët, Worldwide Governance Indicators (WGI)

Siç tregohet nga këto shifra, perceptimet mbi masën në të cilën pushteti publik ushtrohet për përfitime private dhe shtrirja e kapjes së shtetit nga ana e elitave dhe intereseve private, tregojnë nivele të larta të korrupsionit. Korrupsioni renditet si pengesa e dytë më e rëndësishme për të bërë biznes, mbas taksave të larta sipas të dhënave të UNODC për vitin 2012<sup>40</sup>, me një përhapje mesatare të rryshfetit të biznesit me 15.7 për qind. Përhapja e rryshfetit është më e lartë në grupin e bizneseve të vogla. SME-të<sup>41</sup> japin një kontribut të përgjithshëm në GDP-në kombëtare me 75 % dhe mbulojnë 71 % të sektorit të punës.<sup>42</sup> Kështu përhapja e lartë e korrupsionit të vogël në mesin e kompanive të vogla mund të ketë një efekt të dëmshëm, së pari për shkak se ata janë më të prekshme nga rritja e kostove, dhe së dyti për shkak se ata janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe punësimit për një grup të madh të njerëzve në vend. Përveç kësaj, këto kompani kanë një potencial të madh për tu rritur dhe impakti afatgjatë i korrupsionit në këto biznese mund të jetë akoma më i madh.

Një efekt i korrupsionit administrativ mbi mjedisin e biznesit, mund të vijë në formën e reduktimit të investimeve për shkak të frikës të korrupsionit e cila sipas të dhënave të UNODC 2012, rezulton të jetë 3.3 % e të gjitha bizneseve të anketuara.

Në rast se bizneset shohin pengesa për të bërë investime të mëdha për shkak të korrupsionit, kjo do të dëmtojë në masë të madhe procesin e tyre të përmirësimit dhe rrjedhimisht në të ardhmen produktivitetin dhe funksionimin e tyre si dhe zhvillimin e përgjithshëm të bizneseve në vend.

Korrupsioni administrativ/i vogël në dogana në mënyrë të vazhdueshme është renditur ndër më të lartit në vend<sup>43</sup>, dhe sipas Kryeministrit të Shqipërisë, kontraktimi i agjencisë Crown Agents për të monitoruar korrupsionin në dogana, parashikohet që të sjellë një rritje me 1 % të GDP kombëtare, e cila gjenerohet si e ardhur shtesë nga doganat.<sup>44</sup>

Financimi i partive politike në Shqipëri rregullohet me anë të Kodit Elektoral të Republikës së Shqipërisë<sup>45</sup> dhe Ligji mbi Partitë Politike<sup>46</sup>; sipas të cilit lejohet financimi i tyre me fonde publike dhe private. Megjithatë ka pasur disa pretendime për shkelje të legjisllacionit në formën e fondeve të pa deklaruar, duke e fshehur abuzimin me fonde publike apo fonde private që vijnë nga burime të dyshimta apo lobistët shumë të fortë.

40 United Nations Office on Drugs and Crime (2013). Korrupsioni i biznesit dhe krimi në Shqipëri: Impakti i rryshfetit dhe krimeve të tjera në sipërmarrjen private. Mund të gjendet në: [http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Albania\\_Business\\_Corruption\\_2013\\_EN.pdf](http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Albania_Business_Corruption_2013_EN.pdf)

41 Bizneset e vogla klasifikohen të gjithë ato që punësojnë 10-49 punonjës. Për më shumë, referojuni raportit të UNODC (2013).

42 INSTAT (2012), <http://www.instat.gov.al/en/figures/statistical-databases.aspx> (Accessed in May 2014). Për të dhëna në lidhje me kontributin në GDP dhe punësim, shikoni gjithashtu: Demeti T. (2012), Zhvillimi i SME-ve në Shqipëri dhe Programet për të mbështetur Eksportin në kohët e Krizave.

43 Ju lutem referojuni raportit 2011, 2013 të UNODC. Korrupsioni i biznesit dhe krimi në Shqipëri: Impakti i rryshfetit dhe krimeve të tjera në sipërmarrjen private. Doganat janë të renditura të parat ose të dytat në lidhje me frekuencat e rryshfeteve, dhe/ose përhapjen, sipas përvojave të bizneseve.

44 Media shqiptare, Gazeta Panorama, 28/01/2014. Mund të gjendet në: <http://www.panorama.com.al/2014/01/28/dogant-crown-agents-450-kontrolle-ne-muaj>. (Accessed in May 2014)

45 Kodi Elektoral i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me Ligjin nr 74/2012, datë 19.07.2012. Mund të gjendet në: [http://www.cec.org.al/images/stories/Elektoral%20Code%202012%20\(alb\).pdf](http://www.cec.org.al/images/stories/Elektoral%20Code%202012%20(alb).pdf)

46 Ligji për Partitë Politike, nr 8580, datë 17.02.2000. Mund të gjendet në:

Lidhja midis financimit të partive politike dhe ndikimit në mjedisin e biznesit është se biznese të caktuara private që financojnë partitë politike presin trajtim të favorshëm dhe nganjëherë angazhohen në atë që janë konsideruar si praktikë e "kapjes së shtetit" të tilla si lobim të fortë për miratimin dhe / ose zbatimin selektiv të ligjeve dhe rregulloreve që mund të sigurojnë përfitime për ta, evazion fiskal, etj.

Në vijimësi të rekomandimeve të siguruar nga GRECO dhe OSBE, që nga viti 2011 partitë politike janë të detyruara që t'i bëjnë publike pasqyrat financiare vjetore në website të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.<sup>47</sup> Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, gjithashtu janë të detyruara që t'i dërgojnë Komisionit Qendror Zgjedhor raportin financiar për fushatën elektorale, që më pas kontrollohet nga një kompani auditimi ose auditues të pavarur të zgjedhur nga Komisioni Zgjedhor. Ka shumë prova që sugjerojnë që pasqyrat vjetore financiare, si dhe raportet financiare zgjedhore të ofruara nga partitë politike nuk shfaqin të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ekzistojnë shumë evidenca që tregojnë se pasqyrat vjetore financiare, si dhe raportet financiare zgjedhore të ofruara nga partitë politike nuk shfaqin të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 5.3 Ekonomia informale dhe korrupsioni

Ekonomia informale në Shqipëri besohet të jetë në nivele shumë të larta, duke gjeneruar një pjesë të madhe të GDP-së së vendit dhe në këtë mënyrë duke penguar konkurrencën e shëndoshë të biznesit, si dhe reduktimin e ndjeshëm të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet. Deri më tani nuk ka të dhëna zyrtare në lidhje me nivelin e ekonomisë informale, por vlerësime të shumta tregojnë se ajo kap nivelet 30-50 % të GDP-së. Sipas Boka&Torluccio (2013) i cili përdor National Accounts Discrepancies and Kaufmann – Kaliberda Method për të llogaritur ekonominë informale në Shqipëri nga viti 1996 deri në vitin 2013, niveli i saj ka arritur në rreth 30 % të GDP-së gjatë 5 viteve të fundit.<sup>48</sup> Index Mundi (2013) sugjeron se niveli i asj mund të kapë nivelin prej 50 % të GDP-së.<sup>49</sup> Duke patur nivelin e ekonomisë informale në intervalin midis 30-50 % të GDP-së, numri i transaksioneve të paraportuara dhe burimeve që shkojnë për ryshfet, mund të jetë potencialisht i lartë, gjithashtu me mundësi të larta për ushtrimin e presionit të korrupsionit nga ana e bizneseve informale ndaj organeve të kontrollit publik siç mund të jenë zyra e tatimeve, etj. Nga janari i vitit 2014, qeveria shqiptare ka miratuar një sistem progresiv të taksave, të cilat mund të rrisin shqetësimet dhe si pasojë mund të çojnë në rritjen e ekonomisë informale sidomos të bizneseve të mesme (por edhe atyre të mëdha) të cilat do të preferojnë për të deklaruar më pak dhe të përfitojnë nga norma më e ulët e tatimit.

47 Albanian Council on foreign Relations, (2011). Zgjedhjet, paraja dhe demokracia. Mund të gjendet në: <http://shteti-web.org/wp-content/uploads/2012/12/Zgjedhjet-Paraja-dhe-Demokracia-policy-paper.pdf>

48 Boka M., Torluccio G., (2013), Ekonomia Informale në Shqipëri, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol 2 No 8, pg. 212-22.

49 Index Mundi (2013), Profili Ekonomik i Shqipërisë. [http://www.indexmundi.com/albania/economy\\_profile.html](http://www.indexmundi.com/albania/economy_profile.html) (Accessed in May 2014).

## 5.4 Shpenzimet e buxhetit qeveritar dhe ri-shpërndarja e tij

Buxheti i Shqipërisë përbëhet nga Buxheti i Qeverisë, Buxheti Vendor dhe fondet e veçanta. Buxheti i qeverisë në Shqipëri propozohet nga Ministria e Financave dhe votohet më pas në parlament, ashtu edhe siç parashikohet në Ligjin për Buxhetin Vjetor. Teorikisht Kuvendi ka në dispozicion 2 muaj kohë për të diskutuar buxhetin, por zakonisht ai merr në dispozicion jo më shumë se katër javë, duke kufizuar në këtë mënyrë mundësitë për diskutime të thella në komisionet përkatëse.

Pavarësisht procesit të seancave që në përgjithësi janë të mirë organizuara, janë ngritur dyshime në lidhje me cilësinë e debateve gjatë këtyre seancave. Sipas këtyre shqetësimeve, seancat e debatit në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave të Ministrisë së Financave, janë shumë të shkurtra dhe nuk të japin mundësi diskutimi të thelluar. Për më tepër, për të përmirësuar cilësinë e diskutimeve buxhetore parlamentare, Kuvendi i Shqipërisë mund të marrë në konsideratë rekomandimin e OECD (2013), për krijimin e një zyre buxhetore jo-politike, në mënyrë që të adresojë mungesën e kapacitetit analitik të pavarur për deputetët. Kuadri rregullator shqiptar për procesin e buxhetit përfshin të gjitha dispozitat e nevojshme për të garantuar transparencë të plotë të përmbajtjes së sesionit të Kuvendit, megjithatë, në praktikë, publikimi i seancave nuk praktikohet.

Në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit dhe Udhëzimin për Monitorimin e Buxhetit, që nga viti 2006, kur Shqipëria futi buxhetim të performancës, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore paraqesin Raportin tre-mujor të Ekzekutimit dhe Monitorimit të Buxhetit, tek Ministria e Financave. Raportimi i brendshëm ka kryesisht natyrë financiare dhe nuk përmban informacion të nevojshëm për menaxhimin e performancës (Njësisë Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, 2012). Ministria e Financave e ka parë të nevojshme forcimin e monitorimit të buxhetit për të ndërtuar një themel të fortë për formulimin dhe ekzekutimin e buxhetit.<sup>50</sup>

Kuvendi monitoron ekzekutimin e buxhetit gjatë vitit fiskal përmes raporteve tremujore dhe vjetore të paraqitura nga Ministria e Financave. Raportet tremujore merren në kohën e duhur dhe të përshtatshme. Megjithatë, debati duket të jetë i kufizuar në diskutimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Mungesa e kapaciteteve për analizimin e këtyre raporteve në Kuvend është një pengesë e madhe për ushtrimin e të drejtave të monitorimit.

Kontrollet mbi shpenzimet e tjera përveç pagave konsistojnë kryesisht në kontroll ex-ante të faturave. Auditimi i brendshëm në fazën ex-post nuk është shumë funksional, siç kërkohet nga praktikrat më të mira ndërkombëtare. Institucionet buxhetore marrin faturat nga furnizuesit, përgatisin dokumentet e shpenzimeve dhe kryejnë kontrolle ex-ante. Si shumë institucione buxhetore, ato nuk kanë akses në sistemin e thesarit, ato i dërgojnë dokumentet e shpenzimeve në zyrat përkatëse të qarkut të Thesarit që regjistron dhe kryen një kontroll shtesë ex-ante para pagesës. Me këtë praktikë, Ministria e Financave mban një kontroll të fortë qendror në ekzekutimin e buxhetit.


Vlerësimet nuk përdoren shpesh dhe në mënyrë sistematike në Shqipëri edhe pse ndodh që stafi të zhvillojë një raport vlerësimi në bazë të kërkesës nga një ministër. Vlerësimet e hollësishme dhe analiza e devijimeve të performancës mund të ndihmojnë procesin e monitorimit.

<sup>50</sup> Ju lutem referojuni: [http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=GOV/PGC/SBO\(2013\)3/PROV&doclanguage=en](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=GOV/PGC/SBO(2013)3/PROV&doclanguage=en)

## 5.5 Prokurimi publik dhe korrupsioni

Prokurimi publik është kanali kryesor për transferimin e parave nga publiku në sektorin privat dhe një burim kryesor i korrupsionit, për të dy llojet e korrupsionit: korrupsion i vogël dhe korrupsioni politik/madh. Pas një serë shërbimesh të qeverisjes elektronike, Shqipëria ka zbatuar një sistem e-prokurime i cili e ka bërë procesin më transparent duke bërë ofertat publike të aksesueshme në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Pavarësisht nga kjo, shqetësime ende mbeten në lidhje me efektivitetin dhe shkallën reale të reduktimit të korrupsionit në prokurimin publik. Sipas të dhënave të fundit nga 2012 në raportin e KLSH, dëmi ekonomik në prokurimin publik në vitin 2012 arriti në 444.500.000 lekë, duke shënuar kështu nivelin më të lartë në katër vitet e fundit. Kjo ndodhi për shkak të veprimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në shkelje të rregullave të tenderit, duke skualifikuar operatorë ekonomik të cilët ofronin oferta më të ulëta.

Grafiku 21: Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve për vitin 2012 (në lekë 000)



Burimi: Kontrolli i Lartë i Shtetit, 2013

### Rekomandime

**Financimi i partive:** Duhet të ketë një monitorim më efektiv dhe sistematik i financimit të partive politike, në mënyrë reduktimin/eliminimin e financimit joligjor dhe bërjes së procesit të financimit më transparent. Për këtë arsye, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të supervizojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të thellë financimin e partive politike. Gjithashtu, duhet të përmirësohen kapacitetet e tjera njerëzore dhe hetimore ose të bëhet delegimi i tyre tek institucione të tjera që kanë më shumë kapacitete në dispozicion për këto detyra.

**Në lidhje me buxhetin e shtetit:** Çështjet që duhet të adresohen në lidhje me buxhetin e shtetit përfshijnë: përmirësimin e cilësisë së analizës së buxhetit, cilësia e diskutimeve parlamentare në lidhje me buxhetin, monitorim i duhur i shpenzimeve të buxhetit dhe prodhimi i raporteve të vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme. Komisioni i ekonomisë dhe i Financës duhet që të bëjë të mundur realizimin dhe lejimin e diskutimeve më të thella mbi buxhetin e shtetit në seancat individuale. Duhet të realizohen seanca publike, siç është përcaktuar nga kuadri rregullator shqiptar për procesin e buxhetit që nënkupton të gjitha dispozitat e nevojshme për të garantuar transparencë të plotë të përmbajtjes së sesionit të Kuvendit.



Qeveria duhet të vendosë kontroll më të mirë të detyrimeve financiare, ku njësitë e Thesarit, janë të nevojshme për të regjistruar detyrimet financiare në sistemin e Thesarit, kur është nënshkruar kontrata (para sesa një faturë të arrijë). Qeveria duhet të krijojë një kontroll më të plotë të integruar me sistemin e Thesarit, të detyrimeve financiare. Do të ishte më mirë që të ngrihej një zyrë buxhetimi jo-partiake që të forconte cilësinë e diskutimeve parlamentare.

Prokurimi publik: Avancimi i teknologjisë nuk çon domosdoshmërisht në reduktimin e korrupsionit, nëse kjo nuk shoqërohet edhe me trajnimet e përshtatshme të burimeve njerëzore mbi çështjet e korrupsionit apo standardet e etikës, integritetit dhe pavarësisë institucionale.

## VI. SHOQËRIA CIVILE NË ANTIKORRUPSION

### 6.1 Shoqëria civile dhe anti-korrupsioni në Shqipëri: një paraqitje e përgjithshme

Në Shqipëri, nuk ekziston një indeks për të matur nivelin e angazhimit të shoqërisë civile në praktika antikorrupsioni dhe projekte në Shqipëri ose tregues për të matur suksesin e tyre në aktivitete të tilla. Në lidhje me projektet e shoqërisë civile për trajtimin e korrupsionit në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, duhet të theksojmë se të tilla iniciativa kanë filluar të promovohen më tepër, kryesisht për nivelin lokal. Duke marrë parasysh se korrupsioni në nivel kombëtar është me i vështirë për t'u ndaluar dhe projekte madhore dhe fonde janë të nevojshme për këtë qëllim, OJQ-te dhe organizatat internacionale që veprojnë në Shqipëri janë fokusuar kryesisht në projektet që zhvillojnë modele dhe praktika antikorrupsioni në nivel lokal, me një target modest dhe realist për disa komuna specifike. Shoqëria civile në Shqipëri gjithashtu kanë qenë e orientuar drejt këtyre çështjeve, pavarësisht një kërkesë në rritje nga donatorët ndërkombëtarë dhe lokal për të siguruar fonde për projekte në këtë fushë. Shumë nga organizatat donatore dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë të përfshirë në promovimin e të tilla nismave dhe partnerët e shoqatës civile në fushën e antikorrupsionit, kanë qenë kryesisht USAID,<sup>52</sup> Banka Botërore<sup>53</sup>, Bashkimi Evropian së bashku me Këshillin e Evropës<sup>54</sup>, Open Society Foundation for Albania (OSFA), Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Këshilli Britanik.

### 6.2 Fushat e përfshirjes dhe projektet e shoqërisë civile

Me USAID-in që është një pararendës në projektet kundër korrupsionit, që prej fillimit të viteve 2000, organizata ka drejtuar projektin "Reduktimi i Korrupsionit në Shqipëri", që në atë kohë ishte një projekt madhor antikorrupsioni madje edhe duke e krahasuar në shkallë rajoni. Projekti synonte themelimin e një organizate të përbërë – Koalicioni Shqiptar për Anti-korrupsionin (ACAC)- ku struktura të ndryshme do të inkorporoheshin për të punuar së bashku në çështjet e antikorrupsionit në sektorë të ndryshëm. Një aktivitet monitorues ishte gjithashtu pjesë e rëndësishme e punës së ACAC.<sup>55</sup> Projekti i drejtuar nga Këshilli i Evropës dhe i financuar nga Bashkimi Evropian- Projekti kundër Korrupsionit në Shqipëri (PACA)- gjithashtu përfaqësonte një projekt madhor në këtë fushë. Për shkak të kapaciteteve dhe burimeve të limituara të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri për t'u përballur me çështjet e korrupsionit në shkallë kombëtare, ata filluan të rrisin vëmendjen në qeverisjen lokale dhe në çështjet e përgjegjësive, korrupsionit dhe buxhetit. Projekte të rëndësishme u implementuan në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore. Partnerët shqiptarë kanë qenë shumë aktiv në projekte të tilla në shkallë lokale.<sup>56</sup>

52 USAID i drejtuar në mënyrë specifike nga Strategjia Antikorrupsion: Strategjia Antikorrupsion e USAID 2005, me standarde shumë specifike sektoriale. Mund të gjendet në: [http://anti-corruption.org/pmb321/pmb/opac\\_css/doc\\_num.php?explnum\\_id=187](http://anti-corruption.org/pmb321/pmb/opac_css/doc_num.php?explnum_id=187).

53 Indeksi i mirëqeverisjes dhe çështjet e llogaridhënies dhe administrimit publik, kanë qenë pjesë e projektit të financuar.

54 Një iniciativë e madhe: Project Against Corruption in Albania (PACA), e cila inkorporoi shumë komponentë ku shoqëria civile mund të zbatonte shumë projekte mbi korrupsionin.

55 Për më shumë informacion, referojuni: Sadiku, L. (Shtator 2010). Shqipëri, Shoqëria civile kundër Korrupsionit. Mund të gjendet në: [http://www.againstcorruption.eu/uploads/rapoarte\\_finale\\_PDF/Albania.pdf](http://www.againstcorruption.eu/uploads/rapoarte_finale_PDF/Albania.pdf).

56 Për më shumë informacion, vizitoni portalin e Partners: <http://www.partnersalbania.org/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=171&gj=gj2>.

Disa nga projektet e tyre kanë qenë “Transparenca e Qeverisjes vendore ne sigurimin e shërbimeve” dhe “Trajtimi dhe parandalimi i korrupsionit në qeverisjet vendore në Shqipëri”. Transparency International për shumë kohë është përfshirë në nisma antikorrupsioni dhe praktika buxhetore. Së fundmi, ata ne veçanti trajtuan transparencën përmes projekteve të tilla si “Transparenca e qeverisjes lokale” dhe “Rritjen e transparencës dhe promovimin e proceseve vendimmarrëse pjesëmarrëse në qeverisjen lokale në Shqipëri”.<sup>57</sup>

Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin ne Evropë (OSCE) është angazhuar gjithashtu me qeverisjen lokale, me një projekt antikorrupsioni ne 2009 i cili u lanca ne 5 qytete të vogla shqiptare, me qëllimin për të promovuar parimet e një qeverisjeje të shëndetshme.

Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) në Shqipëri, ka nisur së fundmi (prill 2014) programin e tij anti-korrupsion i cili do te zgjasë tre vjet dhe synon “ekspozimin e çështjeve të korrupsionit ne tetë sektorë të ndryshëm, duke përfshirë Mjedisin, Shëndetësinë, Gjyqësorin, Arsimin, Administratën Publike, Qeverisjen lokale dhe Krimin e organizuar”.<sup>58</sup>

Transparency International në Shqipëri, ka synuar gjithashtu drejt projekteve me impakt kombëtar si “sistemi i ndjekjes se shpërndarjes së buxhetit” për implementimin e strategjive kombëtare kundër korrupsionit në Shqipëri.<sup>59</sup>

Përkatësisht, shoqëria civile ka shprehur shqetësim për korrupsionin ne arsimin e lartë,<sup>60</sup> sistemin shëndetësor dhe sidomos sistemin gjyqësor; sidomos korrupsioni në gjyqësor ka tërhequr vëmendjen në raportet e progresit të KE. PACA dhe EURALIUS kanë qenë projekte të përbëra të EU që e adresojnë korrupsionin ne sistemin gjyqësor, por dhe nisma të tjera kanë ardhur direkt nga shoqëria civile. Shoqata Rajonale e Gazetareve Profesionistë në Shqipëri drejtoi një projekt 9 mujor i cili çoi ne identifikimin e rasteve të korrupsionit ne sistemin gjyqësor në qytetet jugore të vendit. Projekte të ngjashme janë implementuar gjithashtu nga Qendra për Çështjet e Informimitin Publik.<sup>61</sup>

Organizatrat e shoqërisë civile, kanë qenë gjithashtu aktorë të rëndësishëm në raportimin e perceptimeve të qytetarëve lidhur me korrupsionin, gjë e cila në shumë raste është bërë çdo vit, duke siguruar baza të shëndetshme për analiza të mëtejshme dhe veprime të bazuara në gjetjet aktuale. Instituti për Zhvillimin e Kërkimeve dhe Alternativave (IDRA) ishte një pararendës në fushën e tij, duke realizuar çdo vit vrojtime për perceptimin mbi korrupsionin që prej 2005.<sup>62</sup> Mbi të njëjtat baza, Transparency International ka zhvilluar një Indeks të Perceptimit të Korrupsionit dhe Transparency International në Shqipëri, duke siguruar analiza të detajuara mbi gjetjet.<sup>63</sup> Për më tepër, në 2013 u realizua një vrojtim shumë i rëndësishëm dhe raportimi u bë nga United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC)—“Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi ne Shqipëri: Impakti i ryshfetit dhe krime te tjera në ndërmarrjet private”.<sup>64</sup>

57 Për më shumë informacion rreth këtyre projekteve, vizitoni: [http://www.tia.al/en/?page\\_id=55](http://www.tia.al/en/?page_id=55) and [http://www.tia.al/en/?page\\_id=63](http://www.tia.al/en/?page_id=63).

58 Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) Albania: <http://birn.eu.com/en/news-and-events/birn-albania-launch-es-anti-corruption-programme#sthash.Im0SSfva.dpuf>.

59 Transparency International Albania: [http://www.tia.al/en/?page\\_id=44](http://www.tia.al/en/?page_id=44).

60 Shikoni më shumë shembuj AESA <http://aesa-al.org/activities.html>.

61 Infocip: <http://www.infocip.org/en/>.

62 Për më shumë vizitoni: <http://www.idra-al.org/en/2projects/projects2005.php?id=2005>.

63 Për më shumë informacion vizitoni Transparency International Albania: <http://www.tia.al/en/>.

64 UNODC (2013). Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Shqipëri: Impakti i ryshfetit dhe krimeve të tjera në sipërmarrjen private. Mund të gjendet në: [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Albania\\_Business\\_Corruption\\_2013\\_EN.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Albania_Business_Corruption_2013_EN.pdf).

### 6.3 Praktikak më të mira mbi antikorrupsionin

Në shumë raste organizatat e shoqërisë civile punojnë të ndara në lidhje me çështjet e korrupsionit. Por, praktikak më të mira janë zhvilluar kryesisht përmes bashkëpunimit të organizatave të ndryshme mbi projekte të gjera dhe sidomos përmes nismave rajonale. Për shembull, Iniciativa Rajonale kundër Korrupsionit shërben si një proces rajonal përmes së cilit qeverisja vendore, organizatat e shoqërisë civile lokale dhe ndërkombëtare, agjencitë bilaterale dhe organizata ndërkombëtare, kombinojnë përpjekjet e tyre për të ndihmuar në frenimin e korrupsionit në Evropën Jug-lindore (SEE)<sup>65</sup> dhe për të siguruar portale anti-korrupsioni për vendet respektive, ku të raportohen të rejtat, raportet, projektet dhe iniciativat e ndryshme në kuadër të korrupsionit. Ky projekt ka lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira mes këtij grupi vendesh, sidomos për të vendosur lidhje mes organeve qeveritare dhe autoriteteve publike. Kjo ishte çështja në 2008, kur Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bashkë-organizoi me Iniciativën Rajonale kundër Korrupsionit, një aktivitet binjakëzues në Tiranë me Agjencinë e Integritetit Rajonal (AIR), të sapo-themeluar në Rumani. "Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte sigurimi i mbështetjes fillestare për AIR, si dhe për të lejuar përfaqësuesit rumun të përfitojnë nga eksperiencia dhe përvoja e kolegëve të tyre shqiptare dhe për të vendosur bazat për një partneritet mes dy organeve homologe."<sup>66</sup>

### 6.4 Partneriteti publik-privat kundër korrupsionit

Ekzistojnë disa raste që duhet të përmenden në kuadër të partneritetit publik-privat, që përfaqësojnë raste të një bashkëpunimi më të gjerë rajonal dhe botëror midis iniciativave të shoqërisë civile dhe qeverive të vendeve të ndryshme. Një nismë e rëndësishme, ku qeveria shqiptare është e përfshirë është Partneriteti për Qeverinë e Hapur (OGP), i cili ka filluar në vitin 2011 dhe ka për qëllim të "sigurojë një platformë ndërkombëtare për reformatoret e brendshëm të angazhuar për të bërë qeveritë e tyre më të hapura, më të përgjegjshme, dhe të ndjeshme ndaj qytetarëve".<sup>67</sup> Shqipëria nën detyrimin e pjesëmarrjes në iniciativë, hartoi Planin e Veprimit të Parë Shqiptar 2012-2013. Transparenca dhe antikorrupsioni ishin pjesë të rëndësishme e këtij programi. Ndërkohë që OGP parashikoi zhvillimin e një partneriteti aktiv mes Qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile shqiptare, sipas Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN), "niveli i bashkëpunimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në kuadër të proceseve të OGP në Shqipëri, mbetet në nivel bazë dhe sporadik".<sup>68</sup> Rrjeti kundër Korrupsionit për Ekonomitë në Tranzicion (ACN) dhe Nisma e Paktit të Stabilitetit Anti-Korrupsion për Evropën Juglindore (SPAI) ishin iniciativat që kishin për qëllim nxitjen e partneritetit publik-privat.

65 Regional Anti-corruption Initiative: <http://www.rai-see.org/about-us/objectives.html>.

66 Portali Shqiptar i Anti-Korrupsionit, Bashkëpunimi dhe Shkëmbimi i Praktikave më të mira në luftën kundër korrupsionit – Aktivitet i binjakëzuar. Mund të gjendet në: <http://www.anticorruption-albania.org/home/regional-anti-corruption-initiative-news/82-co-operation-and-exchange-of-best-practices-in-the-fight-against-corruption-twinning-type-activity>.

67 Open Government Partnership: <http://www.opengovpartnership.org/>.

68 Institute for Democracy and Mediation (2013). Open Government Partnership project – PASOS: Mapping of Open Government Partnership in South East Europe, pg 6. Mund të gjendet në: <http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/-mapping-open-government-partnership-south-east-europe-case-of-albania.pdf>.

Edhe pse ato arritën të krijojnë një partneritet publik-privat ndërmjet iniciativave ndërkombëtare të shoqërisë civile dhe qeverive pjesëmarrëse, në rastin e Shqipërisë, kjo nuk u përkthye edhe si një partneritet i brendshëm. Gjithashtu, pavarësisht nga fakti se shoqëria civile është konsultuar zyrtarisht kur janë paraqitur projektligje dhe strategji, nuk ka angazhim të konsiderueshëm për të përfshirë shoqërinë civile si një aktor jetik në proces. Kjo më tej dëshmon qëndrimin se në Shqipëri "shoqërinë civile nuk konsiderohen si bashkëbisedues të drejtpërdrejtë".<sup>69</sup>

## 6.5 Korrupsioni brenda shoqërisë civile

Korrupsioni brenda organizatave të shoqërisë civile ka qenë gjithashtu një çështje problematike në Shqipëri. Një artikull i kohëve të fundit mbi Çështjet Ballkanike- me një prej autorëve të përmendur në nismat e BIRN- raporto i për nepotizëm dhe korrupsion mes një grupi OJQ-sh në Shqipëri ku u raportua si e përfshirë në këtë çështje edhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë civile.<sup>70</sup>

Pavarësisht faktit që pretendimet nuk u hetuan apo u provuan, kjo ndikon perceptimin publik dhe besimin në organizatat e shoqërisë civile. Pretendime të tjera kanë qarkulluar në median shqiptare mbi fondet e dedikuara komunitetit rom, sidomos atyre të dhëna nga Komisioni Evropian me pretendimet se këto miliona Euro kanë dështuar në përmirësimin e situatës së varfërisë dhe të cenueshme të komunitetit rom në Shqipëri.<sup>71</sup>

Megjithëse të paprovuara ato ja kanë dalë të ndikojnë opinionin publik që organizatat përfituese të këtyre fondeve kanë qenë të korruptuara përderisa nuk arritën të sillnin një rezultat real për grupin target që ato synonin. Ekzistojnë gjithashtu shqetësime lidhur me transparencën dhe raportimet financiare të organizatave të shoqërisë civile. Sipas indeksit të Civics Civil Society në Shqipëri, mes organizatave të shoqërisë civile, 69.5% deklarojnë që informacioni i tyre financiar është publikisht i disponueshëm. Megjithëse ky indikator duket relativisht pozitiv në shikim të parë, raporti më tej shprehet se "thujse 42% e OJQ-ve të vëzhguara zgjedhin të mos i përgjigjen pyetjes se ku është gjetur ky informacion, kurse mes atyre që u përgjigjen pyetjes, më pak se gjysma ofrojnë një burim të disponueshëm të vlefshëm. Duke marrë përasysh këtë informacion të dytë, është e qartë që sektori i shoqërisë civile në Shqipëri përballë me sfida të mungesës së transparencës.

69 Irrera, D. (January 2013). Is Albania ready for Europe yet? Jean Monnet Working Papers in Comparative and International Politics. Pg 3. Available at: <http://www.fscpo.unict.it/EuroMed/jmwp68.pdf>.

70 Rusi, E. & Likmeta, B. (April 2014). Albanian Agency Turns NGO Funding Into Family Affair. The article is available at: <http://www.gazetatema.net/web/2014/04/17/birn-agjensia-shtetere-e-ojfq-ve-financoi-njerezit-e-vet-dhe-shoqata-kunder-opozites/>.

71 "Miliona euro per Romet", 17/08/2013 <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=262249>

72 Civicus & IDM (2010). Civicus Civil Society Index Analytical Country Report for Albania: In search of citizens and impact. Pg 20. Available at: [http://civilsocietyindex.files.wordpress.com/2010/10/albania\\_acr\\_finalprintversion.pdf](http://civilsocietyindex.files.wordpress.com/2010/10/albania_acr_finalprintversion.pdf).

73 Ibid, pg 20.

## Rekomandimet

### Për qeverinë

- Ndjekja përmes përkushtimit të saj për OGP-në, për ta bërë shoqërinë civile një partner të afërt në adresimin e çështjeve të korrupsionit në vend. Projektet dhe nismat e shoqërisë civile në fushën e antikorrupsionit duhet të akomodohen dhe të bëhen pjesë e përpjekjeve të vet qeverisë në këtë fushë;
- Duhet bërë realitet themelimi i platformave të institucionalizuara për konsultim dhe bashkëpunim me shoqërinë civile në fushën e përpjekjeve antikorrupsion. Platformat që u adresohen çështjeve më madhore mund të përdoren gjithashtu për këtë efekt, si psh: Këshilli Kombëtar për integrimin Evropian;
- Të përfshihen organizatat e shoqërisë civile në propozimin për dokumente strategjike të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

### Për donatorët

- Sigurimi i fondeve për zhvillimi për CSO-të aktive në fushën e anti-korrupsionit, në mënyrë që ato të jenë më transparente ndaj publikut, e të fitojnë kështu besimin dhe efektivitetin në audience;
- Ushtrimi i presionit ndaj qeverisë që të përfshijë shoqëritë civile në planifikimin e përpjekjeve antikorrupsion dhe të merren parasysh monitorimet e shoqërisë civile në implementimin e këtyre strategjive.

### Për shoqërinë civile

- Të flasin në mënyrë unanime sa më shumë të munden, ose përmes koalicioneve të mëdha, ose projekteve të përbashkëta të gjera në mënyrë që të rritet impakti në opinionin publik;
- Të zhvillohen lidhje konstruktive me median kombëtare dhe rajonale në mënyrë që të krijohet sinergji në fushën e denoncimit të korrupsionit dhe shpërndarjes së praktikave të mira të anti-korrupsionit;
- Përdorimi i metodave rigorozë transparente të raportimit ndaj publikut duke përfshire më shumë informacion mbi të dhënat financiare përmes raporteve vjetore.

## VII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Shqipëria ka pranuar dhe mirëpritur konventat ndërkombëtare antikorrupsion, dhe i ka parë ato si mënyra për të bërë progres të mëtjshëm dhe për t'u integruar me standardet botërore dhe evropiane. Shqipëria ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në vitin 2003 dhe Konventa është ratifikuar në 2006. Implementimi i plotë i kësaj konvente varet nga parandalimi efektiv i korrupsionit përmes legjislacionit / rregulloreve të qarta, dhe nëpërmjet zbatimit efektiv dhe të paanshëm të ligjit. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit mbështet zbatimin e politikave kundër korrupsionit të Qeverisë së Shqipërisë, duke nxitur një kulturë të mos-tolerancës ndaj korrupsionit në sektorin publik, si dhe masat për të reduktuar vulnerabilitetin e institucioneve qeveritare.<sup>74</sup>

Një konventë tjetër e OKB-së e ratifikuar në Shqipëri (2002), është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Ligjin Penal mbi Korrupsionin që prej vitit 2001. Në vitin 2009 ajo gjithashtu ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Ligjin Civil mbi Korrupsionin.

Shqipëria është anëtare e Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit GRECO, që prej vitit 2001 dhe është anëtare e Qendrës Burimore të Iniciativës Rajonale Anti-Korrupsion për Evropën Juglindore (RAI-SEE).

Rekomandimet e GRECO-s janë marrë në konsideratë nga qeveria shqiptare, edhe pse përputhja e tyre e plotë në kohën e duhur nuk ka qenë gjithmonë e suksesshme. Gjatë raundit të parë të rekomandimit 2000-2002,<sup>75</sup> Shqipëria i përmbushi përfundimisht të gjitha 11 rekomandimet e bëra nga GRECO. Në raundin e dytë ajo pati një përputhje të plotë me 11, përputhje e pjeshme me 1, dhe asnjë përputhje me 1, nga 13 rekomandimet që GRECO kishte ofruar. Në vitin 2009, Shqipëria ratifikoi gjithashtu Konventën e Këshillit të Evropës për Ligjin Civil mbi Korrupsionin. Shqipëria merr pjesë që nga viti 2000 në Nismën Anti-Korrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI), e cila mbulon vendet e Evropës Juglindore.

### 7.1 Progres Raporti për Shqipërinë

Komisioni Evropian publikon progres raportet 6-mujore mbi përparimin e Shqipërisë në drejtim të kriterëve ekonomike, politike dhe përafrimit me legjislacionin e BE-së, si pjesë e Paketës së Zgjerimit. Raporti i para-fundit është lëshuar në 4 qershor 2014 dhe Komisioni konfirmoi rekomandimin e tij që Shqipërisë t'i jepet statusi i vendit kandidat në qershor 2014. Në raportin e kaluar të tetorit 2013, Komisioni rekomandoi statusin e vendit kandidat edhe duke nënkuptuar se Shqipëria duhet të vazhdojë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Edhe pse i mbështetur nga Komisioni Evropian në lidhje me statusin e vendit kandidat, 5 vende votuan kundër tij, mbi motivet që Shqipëria kishte ende shumë për të bërë në lidhje me korrupsionin dhe nivelet e larta të krimit të organizuar.

74 United Nations: <http://www.un.org.al/subindex.php?faqe=details&id=107&mnu=16>

Procedura e vlerësimit u bazua në parimet udhëzuese 3, 7 dhe 6 (Mbi Rezolutën (97) 24 të 24 Parimeve Udhëzuese për 75 luftën kundër korrupsionit). Këto parime lidhen me çështjet e pavarësisë, specializimit dhe mënyrat sesi strukturat kombëtare të mund të angazhohen në parandalimin e luftët kundër korrupsionit gjithashtu në shtrirjen dhe qëllimin e imuniteteve. Për më shumë informacion, referojuni: [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round1/reports%28round1%29\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round1/reports%28round1%29_en.asp)

Për më tepër, qeveria e re kishte pak kohë që ishte rritur në fuqi dhe prandaj e kishte të nevojshme të provonte veten në drejtim të angazhimit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në sektorin publik, si dhe për të vazhduar më tej me reformat në gjyqësor, reformat ekonomike, etj.

Raporti i Tetorit 2013 dha përfundimin se Shqipëria ka bërë progres të mëtjshëm drejt përmbushjes së kriterëve politike të Kopenhagenit për anëtarësim në BE. Kjo u arrit nëpërmjet bashkëpunimit të qeverisë dhe opozitës për të miratuar një sërë aktesh të rëndësishme ligjore në Parlament, duke përfshirë Ligjin për Shërbimin Civil i cili pritet të ketë një ndikim të madh në luftën kundër korrupsionit, të Ligjit të ndryshuar për Gjykatën e Lartë, dhe rregullat e procedurës së Parlamentit. Zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2013 u realizuan në mënyrë të rregullt. Komisioni pranoi se hapa të rëndësishëm ishin arritur në gjyqësor me qëllim rritjen e luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave, dhe për të rritur konfiskimet e aseteve kriminale dhe narkotike. Megjithatë, "masa konkrete për forcimin e përgjegjshmërisë, pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit janë të nevojshme të ndërmerren". Regjistri i hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet duhet të forcohet dhe lufta kundër krimit të organizuar duhet të përmirësohet më tej", - deklaroi Komisioni.

Raporti i fundit nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian mbi përparimin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe në reformën gjyqësore mbështet emërimin e Koordinatorit Kombëtar për Anti-korrupsionin. Edhe pse Komisioni i sheh disa zhvillime të fundit si pozitive, të tilla si nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror, me qëllim thellimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ai gjithashtu thekson se në përgjithësi, bashkëpunimi ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit duhet të përmirësohet, duke përfshirë një sistem të sigurt të shkëmbimit të informacionit, i cili do të përmirësojë efikasitetin e hetimeve.

Raporti njih vullnetin e vazhdueshëm politik për të vepruar me vendosmëri në parandalimin dhe në luftën kundër korrupsionit. Raporti rekomandon që Shqipëria të fokusohet në zbatimin e legjislacionit në lidhje me deklarin e pasurive dhe konfliktin e interesit, të rrisë hetimet pro-aktive dhe të ndërmarrë masa të mëtjshme për të bërë hetimet më efikase, të vazhdojë ndërtimin e përpjekjeve të saj fillestare, në mënyrë që të zhvillohet një histori e qëndrueshme e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit. Reforma e thellë gjyqësore e parashikuar konsiderohet të jetë thelbësore në luftën kundër korrupsionit.

Raporti më i fundit për Shqipërinë është lëshuar në tetor 2014. Komisioni Evropian arriti në përfundimin se llogaridhënia dhe transparenca egjyqësorit janë përmirësuar, së bashku me luftën kundër krimit të organizuar, por lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të mbetet një prioritetet i lartë, me përpjekje të vazhdueshme dhe sistematike për zbatimin unik të legjislacionit për të luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet. Përveç kësaj, raporti në mënyrë të qartë përcakton se Shqipëria duhet të zhvillojë më tej një regjistër të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në këto zona.



Përpjekje të vazhdueshme nevojiten për të forcuar kapacitetet administrative për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien.<sup>76</sup>

## 7.2 Asistenca e huaj në fushën e kundër-korrupsionit

PACA- Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian Me financimin e Komisionit Evropian në kuadër të IPA 2008, Këshilli i Evropës nisi në 1 shtator 2009 një projekt të ri të asistencës teknike kundër korrupsionit në Shqipëri (PACA). PACA kishte për qëllim kontribuimin për demokracinë dhe shtetin e së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, duke rritur zbatimin e politikave dhe strategjive kundër-korrupsionit në përputhje me rekomandimet e GRECO-s dhe MONEYVAL dhe angazhimet e Partneritetit Evropian, si dhe duke kontribuar në parandalimin e korrupsionit në sektorin e arsimit duke përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen sociale në sistemin arsimor. Kryesisht sipas rekomandimeve nga PACA, në 2012 u miratuan nga qeveria shqiptare ndryshime kushtetuese për kufizimin e imunitetit të deputetëve, gjykatësve dhe zyrtarëve të tjerë të nivelit të lartë.

EURALIUS -Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë EURALIUS ka qenë një projekt i financuar nga BE me kohëzgjatje prej 30 muajsh mbi konsolidimin e sistemit të drejtësisë shqiptare. Projekti solli në Shqipëri ekspertizë të nivelit të lartë për të ofruar këshilla ligjore dhe për ngritjen e kapaciteteve të Ministrisë shqiptare të Drejtësisë dhe institucioneve gjyqësore. Ishte një promotor i reformës së regjimit të imunitetit, si dhe përmirësime në kuadrin ligjor të Gjykatës së Lartë, Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Avokatisë, Ndhmës Juridike, Administrimin e Gjykatave, procedurës Civile, dhe Gjykatave Administrative. EURALIUS ofroi ndihmën e saj në reformën e procedurave të brendshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; konsolidimit të dhomës së re të përmbauesve privatë; reformimit të strukturës së brendshme të Zyrës së Avokatit të Popullit; dhe kapaciteteve të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese.

Programi kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (PACO) Projektet PACO Albania 1 dhe 2 janë financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe janë zbatuar nga Këshilli i Evropës nga janari 2001 deri në muajin korrik 2004 pjesë e Programit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (PACO). Projekti është hartuar për të ndihmuar Shqipërinë në parandalimin dhe kontrollin e korrupsionit deri në pikën ku nuk dëmtohet besimi i njerëzve në sistemin politik dhe gjyqësor, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, investimet e huaja dhe integrimin evropian.

Programi i Ndhmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP): Këto dy programe kanë për qëllim përmirësimin e sektorëve të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit penal në Shqipëri.

76 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)

### 7.3 Renditjet sipas Transparency International

Në vitin 2013, sipas indeksit të TI, Shqipëria pati një performancë të dobët, duke u renditur si shteti më i korruptuar në rajon, me një nivel të lartë të perceptimit të korrupsionit në drejtësi, polici dhe sistemin shëndetësor.

Ndryshimi i qeverisë, edhe pse i qetë dhe i rregullt, mund të jetë shoqëruar mbase me më shumë korrupsion dhe presion për korrupsion përpara shumë pak kohësh sesa qeveria e re mori drejtimin. Inspektorët tatimorë ishin shumë të predispozuar që të presiononin bizneset për ryshfete. Kjo ndodh, për shkak të frikës së heqjes nga puna sapo të vinte në pushtet qeveria e re. Për më tepër, fiks në periudhën përpara zgjedhjeve, Maj-Qershor 2013, pati një rritje artificiale të punonjësve në sektorin publik, nga ana e partisë që tani është në opozitë. Kështu, këto dhe të tjera praktika të ngjashme që kanë ndodhur në vitet e kaluara, kanë nxitur rritjen e nivelit të korrupsionit të perceptuar.

Tabela 6: Vlerësimet sipas Transparency International Ranking

	2010	2011	2012	2013
CPI	3.3	3.1	3.3	3.1
<b>RENDITJA</b>	<b>87 / 178</b>	<b>95 / 183</b>	<b>113 / 176</b>	<b>116 / 177</b>

Burimi: Transparency International, 2013, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

#### Rekomandime

Përmirësimi i legjislacionit në përputhje me standardet e BE-së dhe përmirësimin e mëtejshëm të ligjeve aktuale. Megjithatë, duhet theksuar se suksesi i këtyre masave varet nga zbatimi efektiv i ligjit, vullneti politik për të siguruar pajtueshmëri të plotë me ligjin dhe zbatimin në praktikë të legjislacionit dhe rregulloreve të dokumentuara;

Shqipëria ka nevojë që të avancojë me ndërtimin e kapaciteteve, duke patur mbështetjen teknike të huaj dhe duke iu referuar praktikave më të mira. Ndërtimi i këtyre kapaciteteve është i nevojshëm në prokurori dhe polici me qëllim përmirësimin e efikasitetit të investigimit dhe koordinimit midis organeve publike nëpërmjet përdorimit të platformave të përbashkëta.